

Përplasje BDI nuk e do Zendelin në Komision

Fq.3



VMRO NUK HEQ DORË Deri tani 70 amendamente kundër shqipes

Fq.3




Visar Musliu pranë kalimit te Xhenova

Fq.19



Koha

www.koha.mk



KOHA për anigma

Fq.11-14

E PËRDITSHME INFORMATIVE

Viti XII · Numri 3277 · e shtunë/e diel 27 janar, 2018

-5°C | +6°C

15 DEN

AKTUALE

Varrose nëna me katër fëmijë



Mijëra qytetarë kanë marrë pjesë në ceremoninë e varrimit të katër fëmijëve dhe nënës së tyre, të cilët humbën jetën në orët e hershme të mëngjesit të ditës së djeshme pas një zjarri të përmasave të mëdha që kaploi shtëpinë e tyre në rrugën "Goce Dellçev" në Tetovë. Ceremonia e varrimit është zhvilluar në varrezat e Tetovës, ku familjarë...

Fq.9

GLOBI

Shteti që heton hetuesit!

Fq.17

RAJON

2019-a, afati i fundit i Serbisë për Kosovën

Fq.16

STUDIME


Klonohen dy majmunët e parë

Fq.15



AKADEMI PËRKUJTIMORE PËR 73 VJETORIN E HOLOKAUSTIT

“JETA IME...”, RRËFIMI I NJË TË MBIJETUARE



Në nder të viktimave dhe të mbijetuarve të ferrit nazist, por edhe të sakrificës së shqiptarëve që ndihmuan në shpëtimin e shumë jetëve, u promovua edhe libri me kujtime i autores herbreje, “Jeta ime nën pushtimin nazist”, Mimi Kamhi Ergas-Faraxhi. Nga Shkupi në Shkodër, Mimi dhe Alberto, një çift i sapomartuar arratisen që të mos përfundojnë në kampin e përqendrimit në Treblinkë. Janë memoare për të cilat heshti gjithë jetën dhe i shkroi pak kohë para se të vdiste

Fq.4

Më lirë me avion se me autobus

Shkup, 23 janar - Aeroportet në rajon shënojnë rritje të madhe të transportit të udhëtarëve në vitet e fundit. Kjo u arrit falë masave dhe politikave të reja që nënkuptojnë fluturime me çmime të volitshme, hyrja e më shumë kompanive ajrore të reja, mbështetja e fuqishme e qeverive të rajonit për zhvillimin e transportit ajror, si dhe subvencionimi i kompanive lou kost që vendosën destinacione të reja, por

edhe me angazhimi i konçesionarëve të aeroporteve në rajon që modernizuan dhe përmirësuan dukshëm kushtet e punës në aeroportet e rajonit. Të dhënat tregojnë se bile 9 aeroporte në rajon kanë transportuar më shumë se një milion pasagjerë, përkundër vlerësimit të ekspertëve të aviacionit se qarkullimi vjetor edhe me 300 mijë udhëtarë është i mjaftueshëm për punë të pavarur dhe mbijetesë...

Fq.6



EDITORIAL

EKONOMIA NË
RRUGËTREGUESIT
E BRUKSELIT

Emin AZEMI

Strategjitë ekonomike të qeverive kanë brenda vetes një kombinim konceptesh populiste e pragmatike. Në të shumtën e rasteve, janë poentimet populiste ato që sigurojnë edhe parakushte social-psikologjike për etablimin e partive politike në pushtet. Nëse politika mbështetet kryekëput në këto poentime, pa ndonjë platformë më të studiuar zhvillimore, atëherë i bie që ardhja me çdo kusht në pushtet ka qenë qëllimi i vetëm, por jo edhe ideali për të sjellë ndryshime substanciale. Analizat e para të ecurive ekonomike në vend, sa i përket strategjive (sociale-ekonomike) të premtuara parazgjedhore të qeverisë aktuale, nuk japin ndonjë notë optimiste, të paktën sa i përket atyre pak parametrevë që lidhen kryesisht me politikën e çmimeve, tatimeve dhe rrjedhave financiare. Rritja e akcizës së derivative të naftës, paralajmërimi për tatim të dyfishtë për një kategori të ardhurash, emetimi i eurobligacioneve dhe rritja e borxhit tek kompanitë dhe institucionet financiare vendore, shtrenjtimi i disa shërbimeve e prodhimeve, emigrimi i të rinjve si pasojë e mosperspektivës në vend, janë disa nga temat më të përfolura në media, për të cilat partitë e koalicionit qeverisës kishin një qasje krejt tjetër në fushatën parazgjedhore.

Është herët të jepet ndonjë parashikim i përshpejtuar dhe negativ për ecuritë zhvillimore ekonomike e sociale në vend, sidomos për ato që lidhen me politikën qeverisëse që i nxisin këto ecuri, por shenjat e këtij fillimviti kalendarik nuk janë shumë optimiste, ndonëse qeverisë aktuale dhe gjithë faktorëve politikë e institucional, iu duhet edhe një periudhë e caktuar kohore të merren me riparimin e pasojave nga keqqeverisjet e kaluara dhe të rikthejnë kursin e politikave euroingruesë, përfshi edhe tejkalimin e kontesti me Greqinë, në favor të një të ardhmeje evropiane për Maqedoninë. Mirëkuptimi shoqëror qëndron pikërisht në këtë segment dhe do të ishte e tepërt të tregohemi shpirtngulfatës nëse nxitohemi të kërkojmë ndryshime radikale brenda natës. Më e nxituar po del të jetë vetëm një parti opozitare maqedonase, e cila ende nuk ka reflektuar për dështimet në qeverisjen e kaluar, duke vazhduar madje me politika konfliktuoze e mosduruese, përfshi edhe reagimet tepër iracionale lidhur me ligjin që përcakton mënyrën e përdorimit zyrtar të gjuhës shqipe.

Nuk mund ta quajmë të gabuar strategjinë aktuale të Qeverisë dhe Parlamentit, përfshi edhe disa nga ministrat e deputetët shqiptarë (Osmani, Grubi etj.), të cilët janë përqendruar në disa punkte thelbësore të politikbërjes, sidomos në imazhin e asaj që quhet politikë e jashtme, si parakushte edhe për zhvillimin ekonomik e social. Tash më është vërtetuar në praktikë se një nga shkaqet e ngecjes ekonomike e sociale të Maqedonisë në vitet e kaluara, ka qenë qasja izoluese e barrikaduese e ish-kryeministrit në raport në temat e fqinjësisë dhe BE-së, që nuk kanë kaluar pa kosto edhe mbi kurrizin e qytetarëve. Përdorja e kontestit me Greqinë rreth emrit si kauzë për përfitime populiste dhe refuzimi kategorik i gjetjes së kompromisit për tejkalimin e këtij problemi, ka qenë një prej pelerinave më mashtruesve që ish-kryeministri e ka shpalosë në arenën e toreadorëve të tij mitik. Fatkeqësisht ishte edhe një shtresë e shoqërisë maqedonase që u ushqye gjatë kohë me këto lojëra bizare, ndonëse me një fund edhe më dramatik e të palavdishëm se sa toreadorët e plagosur. Përfitimet që i atribuohen politikave racionale euroingruesë, në shikim të parë nuk kanë ndonjë shkëlqim populist me të cilat do të impresionoheshin masat e gjëra, mirëpo në shtigje afatgjata ato janë garancat e vetme të perspektivës së përgjithshme, posaçërisht të këndelljes ekonomike e sociale, me të gjitha efektet përcjellëse rigjeneruese që sjell integrimi në NATO e BE.

Mirëkuptimi shoqëror për rrjedhat ekonomike e sociale në vend, do të duhej ta ketë pikërisht edhe këtë komponentë, sepse pa një proces pozitiv euro-ingrues nuk mund të presim investime (të jashtme e të brendshme) dhe për rrjedhojë ambienti i përgjithshëm nuk mund të premtojë ndryshime radikale në statusin social të qytetarëve.

Por, të gjitha këto, me kusht që të kalohet nga realiteti mitik i mbyllur në balonat e populizmit, në realitetin faktik që do të jetë i prekshëm nga të gjithë. Vetëm në këtë mënyrë qerrija e ekonomisë mund të merr drejtimin e duhur në rrugëtreguesit e Brukselit, në të kundërtën, rrotat e prapme mund të bëhen shumë shpejt udhërrëfyese i pakënaqësive popullore.

GJITHKUND TË NGUCIN MESHKUJ

"Thanë se Albin Kurti e ka pasur fjalën për Dardan Molliqajn, kur ka treguar dje se në Lëvizje ka pasur edhe 'Lëvizje erotike'. Dardani kish pas guxu trimi m'i nguc çikat, ama çikat s'kanë guxu as me tregu që i ka nguc Dardani, aq i rrezikshëm që është. Paramendoje Dardanin hamshor 'rruqi' si Napoleoni tuj i sundu çikat e reja e të varfëra, e ato robneshat tuj u tutë prej lartmadhnisë së tij.

Çfarë pamje buklike! Mos me ta marrë mendja që mashkulli e nguc femrën, kqyrë ti deri ku ka degraduar shoqëria jonë. Prej se e mbaj veten në mend mashkujt i kanë nguc femrat. N'kohë t'gjimnazit kombi ynë shqiptar i kemi pas meshkujt më të zjarrtë, ma t'vendosun, dhe u dashke me 'roje familjare' me shku n'shkollë. Unë qikjo që jam i kam pas bodygardat e mi, jo një, po dhjetë. Nuk t'vetke mashkulli, t'grabitke. Tash kam shku një ditë të gjimnazi në Mitrovicë nuk pashë meshkuj me thika e me 'apasaça' që i presin femrat n'pushim t'gjatë te porta m'i nguc për seriozitet...hiç s'pashë kandidatë andejpari ama, sot e gjithë ditën, ngucen femrat kah të rotullohen, sidomos femrat e mira, 'copa' që u thonë. Nuk mundesh m'i ndal mashkullin kur ta mësyen me ta lshu naj fjalë. Mjafton m'i ra një 'krug' kah xhamia e llapit dhe e sheh ti qysh të ngucin meshkujt, të duket sikur ti je kah ban dritë, e ke hy në një dimension tjetër...

Edhe n'Skenderaj, n'Podujevë, n'Prizren, n'Tiranë e n'Tetovë me shku (gjithkund besa, edhe në Venedik), nëse ndjehesh e nënvlerësuar si femër, menjëherë të hyn vetja n'hujë, se t'japin komplimente sheshit, derisa të të bindin se si ti kurrkush, pehri e kësaj dynjaje. Qysh ka thënë Kanti, gjermanët janë dashnorë të ftohtë, por italianët janë has dashnorë, ashtu edhe te shqiptarët disa rajone i kanë meshkujt më dashnorë se disa rajone tjera. Shqiptarët në përgjithësi ua dinë kimetin femrave, derisa t'i nxanë. Masandej, kur t'i nxanë, i trajtojnë si cuklat, si fëmiu lodrën më të dashur që në fund të lojës e then e ia nxjerr sytë e ia shkulë floktë me rrajë. Se hyna thellë (ku hyna e ku dola). Njeriu është 'i poshtër'. Në momentin që i bën do pare, e shet tokën dhe malin e babës, i shet bullicat dhe loptë, e çel një kafiç dhe një qebaptore, e blen një bemvec, e lshon grunë e parë, e gjen një grua tjetër, të re...Dhe, del me të në sheher dorë për dore. Gjithkund të ngucin meshkujt...mashkullit që janë has meshkuj i ngucin femrat. E tillë është natyra njerëzore. Ndodh që edhe dentisti (me qëllu merakli) kur ke punë te ai, mundohet me shfrytëz rastin kur t'pinë injeksioni, me t'prek n'faqe. Nuk e bën me t'nënçmu, por e bën që i pëlqen. Nuk ka shans mos me t'nguc meshkujt. Por ka shans m'u bë imune. Vetëm në institucionet shtetërore kalon diçka pak më lehtë, se ka komisione për ankesa, janë do mënyra që ia mbledh betë atij që të pengon të rritesh në punë nëse nuk i dorëzohesh. Gjithmonë ekziston mundësia me thënë Jo dhe m'u hakmarr ndaj atij që të kushtëzon ose të bën presion. Sidomos nditë t'sotit, që e incizon, e xhiron dhe ia nxin jetën. Femrat nuk janë mbrojtur kurrë ndaj ngacmimeve sepse i kanë konsideruar ato si gjëja më normale, me t'nguc një mashkull", shkruan në FB, publicistja Kimete Berisha.

MEDIACitate

KËRKOHE
HETIM I PLOTË
PËR ASTRIT
DEHARIN

Familja Dehari, ende nuk ka marrë asnjë përgjigje zyrtare me shkrim nga Prokuroria e Shtetit ose Ministria e Drejtësisë në lidhje me rastin e djalit të tyre, Astrit Dehari. Në një konferencë për media, Sami Kurteshi ka thënë se kërkesa e familjes është hetim i plotë ndërkombëtar i rastit dhe jo auditim të dokumenteve dhe fakteve të krijuara. Poashtu, kërkesë e familjes dhe avokatit nuk është vetëm superekspertizë, që t'i shohë dokumentet të cilat i ka krijuar policia. Këto kërkesa i përsëriti deputeti Sami Kurteshi në një konferencë të Lëvizjes VETËVENDOSJE! si reagim i deklaratave mediatike të ministrit të Drejtësisë dhe Prokurorisë së Shtetit në lidhje me këtë. Pavarësisht miratimit të rezolutës së Kuvendit sipas së cilës familja e Astrit Deharit mund të kërkojë ekspertizë nga çdo vend i BE-së ose SHBA dhe se Qeveria do të kujdesej për të gjitha shpenzimet, për një vit nuk është bërë asgjë. Kurse, më 7 nëntor të vitit 2017, familja e ka takuar kryeministrin Ramush Haradinaj, me kërkesën e vetme, lejimin e hetimit ndërkombëtar. Megjithëse kanë kaluar dy muaj e gjysmë, familja dhe as avokati nuk e kanë marrë asnjë përgjigje nga organet zyrtare në lidhje me kërkesën e tyre, thuhet në njoftimin e VV-së. "E tërë kjo zvarritje ka një qëllim. Ka persona në Republikën e Kosovës që ky hetim të mos ngajë kurrë. Në vend se ky shtet, kjo Qeveri të mundësojë hetim ndërkombëtar ata janë të interesuar ta heshtin këtë rast dhe njëjtë po veprojnë edhe me rastin e aktivistëve tanë të dënuar për sulmin në Kuvend. Aktivistët janë dënuar pa fakte objektive, materiale", thuhej në këtë njoftim.

(Klan Kosova, 26 janar)

NËSE NUK
E KENI DITUR...

ÇFARË ISHIN KUVENDET BALLKANIKE?

Kuvendet ballkanike (shek.XVII) ishin kuvendet e krerëve të lëvizjeve kryengritëse antiosmane të popujve të Ballkanit. Në kuvendet ballkanike u hartuan projekte për çlirimin e Ballkanit, në të cilat vend me rëndësi zinte lufta e popullit shqiptar. Që në vitin 1608 në manastirin e Moraçës pranë liqenit të Shkodrës, u mbajt një kuvend

ndërmjet krerëve shqiptarë, serbë, malazez e maqedonas. Kuvendi i parë me përmasa të përgjithshme ballkanike u mbajt në zemrën e Maleve Shqiptare, në Kuç, në verën e vitit 1614. Me të tilla përmasa u mbajtën edhe Kuvendi i Prokupit më 1616 dhe i Belgradit më 1620. Në të tri kuvendet shqiptarët u përfaqësuan si unitet më vete.

PËRPLASJE BDI-BESA NË KOMISIONIN PËR ZGJEDHJE DHE EMËRIME

BDI NUK E DO ZENDELIN NË KOMISION

Të premten gjatë një konference për shtyp, siç tha Fadil Zendeli, me të dëgjuar propozimin nga deputetë e BDI-së, ka kërkuar pauzë 15 minutëshe dhe ka braktisur mbledhjen menjëherë. Nga ana tjetër, deputeti Ejup Alimi tha se nuk bëhet fjalë për shkarkimin e deputetit të BESËS, por për shtimin e numrit të anëtarëve nga 13 në 15



putetin e BDI-së, Ejup Alimi. Kjo ishte një sjellje mjaft e ulët dhe e pamoralshme e deputetëve të BDI-së. Posa dëgjova këtë propozim, menjëherë kërkoja pauza 15 minuta dhe braktisa mbledhjen", tha deputeti Zendeli. Nga ana tjetër, deputeti Ejup Alimi tha se nuk bëhet fjalë për shkarkimin e deputetit Fadil Zendeli, por për shtimin e numrit të anëtarëve nga 13 në 15, edhe atë një nga LSDM dhe një nga BDI. Siç tha Alimi, kjo për të zhbllokuar punën e këtij komisioni të rëndësishëm dhe për të reflektuar shumicën parlamentare në çdo komision parlamentar. "Ky komision ka një vit që nuk mund të funksionojë normalisht dhe është njëri ndër komisioni më të rëndësishëm nga i cili varet shumë emërimet në institucione të rëndësishme shtetërore. Dihet që VMRO nuk merr pjesë në komisione, ndërsa Fadil Zendeli fshihet prapa dyerve të Parlamentit. Nuk bëhet fjalë për

shkarkimin e tij, por për shtimin e numrit të anëtarëve nga 13 të bëhen 15, një nga BDI dhe një nga LSDM me qëllimin që ky komision ashtu si dhe të gjitha komisionet tjera të përbëhet nga partitë e shumicës parlamentare", tha Alimi nga BDI. Para tij, nga LSDM u prononcua kryesuesi i përkohshëm i Komisionit, Hari Lokvenec, duke thënë se ishte vetëm një propozim nga BDI pa e marrë siç tha ai, epilogun e tij. "Sot në Parlament është demonstruar demokraci e lartë. E hapa seancën dhe mora propozim nga BDI. Kolegu Zendeli kërkoi procedurale dhe 5 minuta pauzë dhe unë ja dhashë. Pasi që propozimin e mora në seancë, nuk mundem ta komentoj më shumë. Logjikisht është për shkak të përbërjes së shumicës në Parlament që të ketë ndryshime të anëtarëve. Ishte vetëm një propozim nga deputetët e BDI-se pa e marr epilogun e vet", deklaroi Lok-

venec. Në mungesë të kryetarit të këtij Komisioni, Ilija Dimosvki, kryetari i Parlamentit ka caktuar kryesues të përkohshëm deputetin nga LSDM-së, Hari Lokvenec. Ndërsa lidhur me këtë çështje, kryetari i Komisionit në fjalë, Ilija Dimosvki, ka thënë se ndryshimi i Zendelit me kuadër të BDI-së është shkelje e marrëveshjes së deritani-shme. "Unë nuk mora pjesë në seancë për shkak të bojkotit të Parlamentit. Por, nëse ka pasur propozim për ndryshim të anëtarit të Komisionit nga Lëvizja BESA me

kuadër të BDI-së, ajo nuk është në pajtueshmëri me praktikën dhe proceset demokratike. Ajo është shkelje e marrëveshjes", tha Dimosvki për portalin "dokaz.mk". Sipas përbërjes aktuale, VMRO ka më shumë deputet në Komision edhe atë 6, kryetarin Ilija Dimosvki, zëvendëskryetarin Zoran Iljoski, anëtar tjerë Kërste Mukovski, i cili aktualisht gjendet në paraburgimi akuzuar për dhunën e 27 prillit në Parlament, Antonio Milloshovski, Daniella Rangellova, Dimitar Stefanaxhija dhe Lupço Dimosvki. Nga LSDM anëtar janë Goran Misosvki, Hari Lokvenec, Kostadin Kostadinov, Muhamet Zeqiri dhe Ivana Tukvexhiq, nga BDI Artan Grubi, ndërsa nga Lëvizja BESA, Fadil Zendeli. Pikërisht ky i fundit është çelësi për të pasur kuorum në komisioni qoftë dhe për të propozuar shtimin e numrit të anëtarëve siç thanë nga BDI. Gjatë një konference për shtyp të thirrur ena për ligjin për gjuhët nga Vllatko Gjoçev i VMRO-së, në lidhje me Komisionin për zgjedhje dhe emërimet tha se përbërja e këtij Komisioni për zgjedhje dhe emërimet nuk mund të ndryshohet dhe LSDM të ketë anëtar të njëjtë me këtë parti, meqë sipas tij, VMRO ka legjitimitetin në popull. "Ne duhet të kemi më shumë deputetë se LSDM në këtë komision. Ata nuk kanë legjitimitet, e shihni si kanë kapur të gjitha institucionet duke filluar nga Qeveria dhe shumë institucione tjera shtetërore", u përgjigj Vllatko Gjoçev në pyetjen e gazetarëve se VMRO meqë nuk ka shumicën prej 48 deputetëve, pse duhet të ketë më shumë anëtarë në Komision sesa LSDM.

Koha

Fatos RUSHITI

Shkup, 26 janar - Deputeti i Lëvizjes BESA, Fadil Zendeli, ka akuzuar partitë e shumicës parlamentare - BDI dhe LSDM se me pa të drejtë kanë dashur ta shkarkojnë nga të qenurit anëtar i Komisionit për zgjedhje dhe emërimet dhe ta zëvendësojë atë me deputetin e BDI-së, Ejup Alimi. Të premten gjatë një konference për shtyp, siç tha Fadil Zendeli, me të dëgjuar propozimin nga deputetë e BDI-së, ka kërkuar pauzë 15 minutëshe dhe ka braktisur mbledhjen menjëherë. "Përkundër ndihmës të deputetëve të Lëvizjes BESA dhe ndihmës sime për t'i mundësuar shumicës që të kenë kuorum në komision, u befasova kur dëgjova propozimin nga deputeti i BDI-së që unë të zëvendësohem me de-

VMRO-DPMNE E VENDOSUR TA PENGOJË LIGJIN

DERI TANI 70 AMENDAMENTE KUNDËR SHQIPES

Deputeti i VMRO-DPMNE-së tha se sjella e tillë e Ligjit për përdorimin e gjuhëve ka të bëjë ekskluzivisht me dëshirën e LSDM-së dhe të BDI-së që me çdo çmim ta ruajnë koalicionin dhe pushtetin



Shkup, 26 janar - Grupi i deputetëve të VMRO-DPMNE-së deri tani ka parashtruar 70 amendamente për Ligjin me të cilin avancohet përdorimi i gjuhës shqipe, e sa do të jetë numri i përgjithshëm, sipas Vllatko Gjoçevit, do të varet nga përgjigja e shumicës në pushtet për kërkesat e tyre për tërhe-

qjen e tekstit dhe për dialog. Gjoçev në konferencë për shtyp në Parlament tha se ata janë të gatshëm të bisedojnë për Ligjin, për të cilin vlerësojnë se duhet të miratohet me konsensus. Ai vlerëson se teksti i Ligjit duhet të përgatitet përmes dialogut, që do të thotë avancimi i të drejtave jo vetëm të gjuhës shqipe, por edhe të gjuhëve të bashkësive më të vogla, dhe njëkohësisht të jetë në pajtim me Kushtetutën.

"Të formohen grupe punuese, të konsultohet opinioni ekspert,

të shihen përvojat ndërkombëtare. Ne jemi të gatshëm të diskutojmë për përfshirje më të madhe dhe përdorimin e gjuhëve në Republikën e Maqedonisë. Njëkohësisht nuk dëshirojmë të merren vendime që janë të përgatitura në shpejtësi. Nuk është mirë vetëm në emër të formimit të ndonjë koalicioni në afat të shkurt të bëhen ligje që janë të këqija, të pathëna dhe të cilat numëri i madh i njerëzve nuk dinë si t'i zbatojnë, as, t'i kuptojnë" tha Gjoçev. Deputeti i VMRO-DPMNE-së tha se

sjella e tillë e Ligjit për përdorimin e gjuhëve ka të bëjë ekskluzivisht me dëshirën e LSDM-së dhe të BDI-së që me çdo çmim ta ruajnë koalicionin dhe pushtetin.

"Qartë ishte se LSDM-ja i humbi zgjedhjet e kaluara, por me çdo çmim dëshiroi të formojë qeveri. Ai çdo çmim të cilin ata ishin të gatshëm ta ofrojnë është, mes tjerash, edhe ky ligj. Problemi është se ky ligj është kontestuar nga numri i madh i ekspertëve në vend, nga presidenti, bashkësitë lokale nuk dinë si ta zbatojnë këtë

ligj...", tha Gjoçev. VMRO-DPMNE opozitare do të marrë pjesë në Parlament vetëm në pjesën që ka të bëjë me Ligjin për gjuhët, e në tjetër tani për tani nuk do të marrë pjesë. Ndryshe, në BDI janë shprehur të sigurt se e kanë "çelësin" për të bllokuar planin e zvarritjes së VMRO-së për Ligjin e gjuhës shqipe, ndërsa merret vesh se LSDM ashtu sikurse Lëvizja BESA nuk do të dorëzojnë amendamente për të ndryshuar Ligjin që tashmë u abrogua nga presidenti i shtetit, Gjorgje Ivanov. (F.R)

Në nder të viktimave dhe të mbijetuarve të ferrit nazist, por edhe të sakrificës së shqiptarëve që ndihmuan në shpëtimin e shumë jetëve, u promovua edhe libri me kujtime i autores herbreje, "Jeta ime nën pushtimin nazist", Mimi Kamhi Ergas-Faraxhi. Nga Shkupi në Shkodër, Mimi dhe Alberto, një çift i sapomartuar arratisen që të mos përfundojnë në kampin e përqendrimit në Treblinkë. Janë memoare për të cilat heshti gjithë jetën dhe i shkroi pak kohë para se të vdiste, në mënyrë që tmerri i gjenocidit nazist të mos harrohej

Koha

Evis HALILI

Shkup, 26 janar - Përvjetori i 73-të i çlirimit të kampit nazist të Aushvicit është shënuar me një Akademi përkujtimore të organizuar nga Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore (ITSHKSH), shoqata "Acta Non Verba", në bashkëpunim me Sekretariatën e Çështjeve Evropiane. Në nder të viktimave dhe të mbijetuarve të ferrit nazist, por edhe të sakrificës së shqiptarëve që ndihmuan në shpëtimin e shumë jetëve, u promovua edhe libri me kujtime i autores herbreje, "Jeta ime nën pushtimin nazist", Mimi Kamhi Ergas-Faraxhi. Nga Shkupi në Shkodër, Mimi dhe Alberto, një çift i sapomartuar arratisen që të mos përfundojnë në kampin e përqendrimit në Treblinkë. Janë memoare, për të cilat heshti gjithë jetën dhe i shkroi pak kohë para se të vdiste, në mënyrë që tmerri i gjenocidit nazist të mos harrohej. Kujtimet e Mimi Kamhi Ergas-Faraxhi janë simbol i së mirës dhe shtytje në betejën e pareshtur për drejtësi, ka thënë zëvendëskryeministri për Integrim dhe çështje evropiane, Bujar Osmani, në fjalën e hapjes.

"Megjithëse janë të shumta sfidat që janë të shoqëruara me pa-

AKADEMI PËRKUJTIMORE PËR 73 VJETORIN E HOLOKAUSTIT



"JETA IME...", RRËFIMI I NJË TË MBIJETUARE

qëndrueshmëri në periudha të caktuara kohore, prapëseprapë vendi ynë sot është aspirant për t'u bërë anëtare me të drejta të plota në NATO dhe BE dhe po bëjmë çmos për të vënë në jetë vlerat evropiane për barazi, humanizëm dhe solidaritet. Kjo për shkak se këto vlera janë të mishëruara në premisën e antifashizmit, dhe që sigurojnë prosperitetin si arritje qytetërore, në mënyrë që krimet kundër njerëzimit të mos përsëriten", u shpreh Osmani. Ambasadori i Izraelit Dan Oryan, duke folur për simbolikën e kësaj date përkujtimore, 26 janarin, që shënohet kudo në botë, tha se qëllimi është që historia e holokaustit dhe tragjedia e popullit hebre të mos përsëritet. Duke iu referuar aktivitetëve në Maqedoni, krijimit të Fondit, Qendrës së holokaustit, botimeve, e të tjera, tha se duhet të bëhet akoma më shumë punë. Për drejtorin e ITSHKSH, Skënder Asani, ky libër do t'u shër-

bejë historianëve për të zbardhur sa më mirë rrethanat e Holokaustit, por edhe shkollave dhe universitete si literaturë referuese.

"Kemi hapur një proces të munguar deri më tani edhe nga historiografia shqiptare, dhe me zbardhjen e rasteve në vitet e fundit, po dëshmojmë se edhe pas shtatë dekadave, çështja e shpëtimin të hebrenjve është shumë e freskët, po ngjallë emocione të shumta dhe po motivon hulumtuesit për të zbardhur raste të reja. Në manifestimin e vitit 2015, mundësuam emetimin e filmit dokumentar "Besa", dhe dhjetë ditë para emetimit, producentët na kontaktuan për të na sugjeruar se është paraqitur një personazhe e mbijetuar, e cila ka shprehur dëshirë që të jetë pjesëmarrëse në këtë ngjarje dhe për të treguar rrëfimin e saj. Me kënaqësi i bëmë ftesë zonjës Ita (Drita) Bartuv, për të qenë pjesë e

evenimentit. Ky ishte edhe momenti që na mundësoi neve sot të tubohemi bashkë për të promovuar këtë libër me kujtime të nënës së saj", ka thënë Asani.

Në promovimin e librit me kujtime "Jeta ime nën pushtimin nazist" i autores Mimi Kamhi Ergas-Faraxhi, ka qenë prezente e bija e autores Ita (Drita) Bartuv, e cila të drejtat autoriale për botimin e këtij libri autobiografik në tre gjuhë ia ka dhënë ITSHKSH. "Jam shumë e lumtur që kujtimet e nënës time do të kontribuojnë në studimin e holokaustit nëpërmjet historisë së saj personale. Por më i rëndësishëm është fakti se historia e saj ndriçon një anë tjetër të qenies njerëzore, të tyre që shpëtojnë jetë njerëzish, duke vepruar nën një kod nderi, siç është Besa, e veçantë dhe e jashtëzakonshme", thotë Bartuv për këtë libër. Pas Shkupit, "Jeta ime nën pushtimin nazist" do të promovohet edhe në Shkodër.

UNË JAM DRITA!

Në një intervistë për KOHA, tre vjet më parë, Ita Bartuv ka rrëfyer historinë e familjes së saj, që jetonte në lagjen hebreje të Shkupit, lagje që më pas u shkatërrua nga gjermanët. "Ne jetonim këtu prej 300 vjetësh. Të gjithë u lindën këtu, prindërit e mi, familja ime. Mamaja ime rridhte nga një familje shumë e madhe. Edhe im atë vinte nga një familje me 8 fëmijë. Më 10 mars, një miku ynë, një mik i familjes sime, jo imi, sepse unë nuk isha lindur ende, erdhi e na tha që atë natë do t'i fshihnin çifutët që ishin këtu në Shkup, do t'i fshihnin në një dollap. Na tha se kush nuk kish arritur të fshihej tashmë ishte në burg. Kështu që prindërit e mi u nisën, shkuan në Ferizaj, e prej andej kaluan në Shqipëri. Ishin pajisur me pasaporta false, kishin emra myslimanë. Im atë quhej Ali Faik Myrtezaji. Nëna ime mori emrin Emine. Kur mbërritën në Shkodër, nënës sime ju

desh të mbulohej me çarçaf. Ditën e parë që mbërritën atje e burgosën. Një mik i babait tim, që ishte mysliman, erdhi në burg e iu tha se - Është miku im, dhe e lanë të lirë. Ai na mori dy vjet në shtëpinë e tij. Atje u linda unë, në fund të atij viti. Më vunë emrin Drita. Ky ishte emri im. Jetuam atje 3 vjet, deri në mbarim të luftës. Të gjithë tregoheshin shumë të dashur me prindërit e mi. Edhe me mua, më llastonin. Në atë kohë lufte nuk para lindeshin fëmijë. Të gjithë donin të më merrnin në krahë, të më ushqenin e të luanin me mua. Ishte diçka e mrekullueshme...", thotë Bartuv. Kur mbaroi lufta u rikthyen në Shkup me shpresën se do të kthehej ndokush nga familja e tyre. Por askush nuk u kthye më, 60 pjesëtarë të familjes u vranë në kampin e Treblinkës, qysh ditën e parë që i shpunë atje. Vetëm ata të dy shpëtuan, sepse u vendosën në Shqipëri.



Durlovski në arrest shtëpiak, masa kujdesi për Peshevskën

Shkup, 26 janar - "Këshilli penal i Sektorit për krim të organizuar dhe korrupsion pranë Gjykatës themelore Shkup, duke vepruar sipas propozimit të Prokurorisë Themelore Publike për ndjekje të krimit të organizuar për vazhdimin e masave për sigurimin e pranisë kundër 35 personave lidhur me ngjarjet e 27 prillit të vitit 2017 të cilat kanë ndodhur në Kuvendin e RM-së për veprën penale nga neni 313 nga K3, solli vendime me të cilat e pranoi propozimin e prokurorisë edhe të: K.M, S.V, L.A, M.Ç, D.L, G.GJ, O.P, O.R, M.P, A.A, I.C., B.D., B.I., V.J., M.P, Z.S., J.Ç, I.S., G.A, V.T., dhe V.M". ua vazhduan masën e paraburgimit në kohëzgjatje prej 30 ditëve. L.D, J.T, S.M, S.M dhe M.M ju është vazhduar masa e arrestit shtëpiak, për E.D.B dhe I.D. e pranuan propozimin e Prokurorisë dhe ua hoqën masën e paraburgimit dhe iu caktuan masë të arrestit shtëpiak edhe Zh.P. e pranoi propozimin e Prokurorisë dhe e hoqi masën e arrestit shtëpiak, ndërsa i caktoi masë për kujdes, gjegjësisht - Ndalesë për ta lëshuar vendbanimin, të ketë si obligim i akuzuari të paraqitet te personi i autorizuar zyrtar në Gjykatë, Marrje e pasaportës dhe ndalesë për dhënie të pasaportës së re dhe Ndalesë për afrim dhe krijim, gjegjësisht të ketë kontakte me persona të caktuar, theksohet në kumtesën e Gjykatës Themelore Shkupi 1.

ZAEVI NË DAVOD TAKOI EUROKOMISARIN JOHANES HAN

TAKIMI ME CIPRASIN LAJM I MIRË EDHE PËR RAJONIN DHE BE-në



Shkup, 26 janar - Takimi i kryeministrit Zoran Zaev me kryeministrin grek Aleksis Cipras është me rëndësi të madhe edhe për zhvendosjen e proceseve euro-integruese të Republikës së Maqedonisë, dhe i bën shumë më reale pritjet se viti 2018 mund të jetë vit historik për Maqedoninë, për rajonin dhe për BE-në. Kjo të premtën është konkluduar në takimin në Davos të kryeministrit Zoran Zaev me komisararin evropian për poli-

tikë fqinjësore dhe negociata për zgjerim, Johannes Han, në Forumin Ekonomik Botëror. Zaev e ka informuar Hanin për takimin me kryeministrin grek dhe e ka njoftuar me rezultatet e realizuara nga ai takim të cilat në masë të madhe e lëvizin procesin e negociatave të të dy vendeve lidhur me problemin të cilin Greqia e ka me emrin kushtetues të Republikës së Maqedonisë, si dhe në lidhje me potencialet për zhvendosje të re, cilë-

sore të marrëdhënieve dypalëshe", kumtoi pres shërbimi qeveritar. Komisarari evropian ia transmetoi Zaevit dhe qëndrimin e tij të drejtpërdrejtë për takimin me Ciprasin të shprehur menjëherë pas ngjarjes në rrejetet sociale dhe nënvizoi se takimi është shumë lajm i mirë, i cili tregon guxim, vizion dhe aftësi politike, dhe se zgjidhja e kontestit shumëvjeçar do të jetë mirë për të dy vendet, rajonin dhe Evropën. Zaev në takimi

ka theksuar se takimi është i rëndësishëm edhe për inkurajim të implementimit të reformave të qëndrueshme të filluara në Maqedoni, dhe se e konfirmon vullnetin politik të Qeverisë t'i mbyllë çështjet e hapura për një kohë të gjatë me vendet fqinje, ta nxisë dinamikën rajonale dhe të jetë partner i besueshëm i miqve të tyre ndërkombëtar paralelisht me realizimet e përditshme edhe në skenën e përgjithshme.

Deputeti i ASH-së, Ziadin Sela, sipas aktakuzës së ngritur nga Prokuroria Publike e Shkupit, pas sulmit dhe rrahjes ekstreme nuk ka dhënë shenja jeta, me çka të dyshuarit janë larguar, duke menduar se ai ka ndërruar jetë. Pendimi apo vetëdija e këtyre të akuzuarve, siç tha prokurori publik Darko Jakimovski, nuk janë arsyeja bazë se pse deputeti Sela sot është në mesin tonë

FILLOI GJYKIMI PËR "TENTIM VRASJEN" NDAJ ZIADIN SELËS



ALIVANOSJA E KISHTE SHPËTUAR SELËN, JO MËSHIRA E DHUNUESVE

Koha Omer XHAFFERI

Shkup, 26 janar - Dhjetë të dyshuarit për "tentim vrasje" të deputetit dhe kreut të Aleancës për Shqiptarët, Ziadin Sela, të premtën u ulën në bankën e të pandehurve në Gjykatën Penale të Shkupit. Përfaqësuesi i aktakuzës nga Prokuroria Publike, Darko Jakimovski, në fjalët hyrëse tha se të akuzuarit paraqesin vetëm një pjesë të ngjarjes dhe veprimeve penale që janë regjistruar mbrëmjen e 27 prillit të viti 2016 që ndodhën në Parlamentin e Maqedonisë. Listën e personave të akuzuar për këtë vepër penale e kryesojnë babai dhe i biri, Cejo dhe Kire Gjeorgjievski, Andrea Micov, Stojan Pavlevski, Nikolla Vojminovski, Kosta Dellov, Aleksandar Janevski, Sasho Senkov, Oliver Oshakovski dhe Nikollçe Dimitrievski.

Deputeti i ASH-së, Ziadin Sela, sipas aktakuzës së ngritur nga Prokuroria Publike e Shkupit, pas sulmit dhe rrahjes ekstreme nuk ka dhënë shenja jeta, me çka të dyshuarit janë larguar, duke menduar se ai ka ndërruar jetë. Pendimi apo vetëdija e këtyre të akuzuarve, siç tha

prokurori publik Darko Jakimovski, nuk janë arsyeja bazë se pse deputeti Sela sot është në mesin tonë. Por fakti është se nga rrahja brutale, ai nuk ka lëvizur fare dhe të dyshuarit për "tentim vrasje" e kanë lënë në atë gjendje duke menduar se Sela ka vdekur. "Me prezantimin e dëshmitëve në këtë proces gjyqësor, ne do të vërtetojmë se në çastet e sulmit dhe rrahjes ekstreme që i është nënshtruar Ziadin Sela, ndërgjegjja e të akuzuarve nuk ka qenë shkak për të shpëtuar ai. Ekspertiza e kryer nga mjekësia ligjore në masë të madhe do të sqarojë se të gjitha lëndime, pala e dëmtuar i ka në pjesën e kokë. Paralelisht me prezantimin e këtyre fakteve, përmes dëshmisë së këtyre ekspertëve do të vërtetojmë se lëndimet e rënda trupore kanë qenë rrezik për jetën e tij. Njëkohësisht, do të sqarohet edhe lloji i lëndimeve, mjetet me të cilët janë shkaktuar ato goditje dhe pasojat nga të njëjtat", tha prokurori Jakimovski. Përshkrimi e shkurtër i aktakuzës, sipas prokurorit të rastit në fjalë, u realizua pa prezantimin e numrit dhe llojit të dëshmitëve, me të vetmin qëlli-

mi respektimin e parimit të prezumimit të pafajësisë. Megjithatë, të gjitha fotografitë, xhirimet dhe provat tjera materiale, ai shtoi se do të publikohen ashtu siç rrjedhin fazat e procesit gjyqësor. Pala mbrojtëse e të akuzuarve, pas dëgjimit të fjalëve hyrëse të prokurorit, theksoi se kjo aktakuzë nuk është e qëndrueshme. Qëndrimi i shumicës prej tyre ishte se për të qenë një aktakuzë e qëndrueshme, duhet të ekzistojë qëllimi i theksuar, e kjo siç thanë ata - nuk figuron në aktakuzë. Avokati i të akuzuarit Stojan Pavelski, mes tjerash shtoi se klienti i tij nuk ka marrë pjesën në rrahjen e deputeti Ziadin Sela, por përkundrazi - ai ka asistuar në shpëtimin e tij. Për këtë shkak, ai kërkoi lirim nga aktakuza dhe kërkim-falje nga ana e prokurorisë. Nga ana tjetër, mbrojtja e të akuzuarit Kosta Dellov (i cili ishte lavdëruar në rrjetet sociale se "ndjenjë e mirë ishte goditja e Selës"), theksoi se klienti i tyre në Parlament është futur pas hapjes së dyerve nga turma e madhe dhe se kjo ka ndodhur si shkak i emocioneve të përziera.

Tutje, edhe pse në këtë proces si i dëmtuar paraqitet vetëm

deputeti Sela, pjesë e kësaj lëndë gjyqësor janë një varg dëshmitarësh duke filluar nga deputetë, ministra dhe punëtorë medial. Në mesin e dëshmitarëve, të cilët të premtën u paraqit të jep deklarata, ishte edhe ministri për Shoqëri Informatike dhe Administratë, Damjan Maçevski. Ndërkohë, deputetit Muhammed Zeqiri ftesa për pjesëmarrje në seancë gjyqësor, në cilësinë e dëshmitarit nuk i ishte dorëzuar me kohë. Nga ana tjetër, paraprakisht edhe pse e kishte pranuar ftesën për dëshmitarë në këtë proces, kryeparlamentari Talat Xhaferi e kishte njoftuar Trupin gjykues për shkak të obligimeve zyrtare, nuk do të jetë në gjendje të marrë pjesë në seancë. Ndryshe, deputeti Sela kësaj radhe nuk ishte prezent në sallën e gjykatës, por qëndrimin e tij e përfaqësoi avokati Abdul Abdyl. Seanca e radhës për këtë lëndë gjyqësore është caktuar të mbahet me datë 8 shkurt, kur edhe pritet që dëshmitë e tyre t'i prezantojnë ekspertët nga Instituti për mjekësi ligjore, dy gazetarë të cilët atë mbrëmje kishte qenë në pres-qendrën e Parlamentit dhe vetë i dëmtuari Ziadin Sela.

KRONIKË

Abuzohet një 12-vjeçar në rrethinën e Prilepit

Një fëmijë 12-vjeçar nga fshati Prasad i Prilepit, para pesë ditëve është abuzuar nga një 18-vjeçar nga Prilepi. Siç kumton MPB-ja, Zyra e jashtme për punë kriminalistike Prilep dorëzoi kallëzim penal kundër banorit të Prilepit për vepër të kryer penale "sulm gjinor ndaj fëmijës i cili nuk ka mbushur 14 vjeç". Abuzuesi më datën 21 të këtij muaji rreth orës 20:30 në afërsi të fshatit Prasad, ka kryer abuzim seksual ndaj fëmijës.

Dyshohet se një prind ka abuzuar seksualisht vajzën e tij

Të enjten në Stacionin Policor në Tetovë, një drejtor i një shkolle fillore ka denoncuar se dy nxënëse të klasës së tetë i kanë treguar se një nxënëse 14-vjeçare është keqtrajtuar seksualisht dhe psikikisht nga ana e babait të saj. Pas këtij denoncimi, drejtori ka ftuar nxënësen dhe e njëjta ka vërtetuar atë se çka kanë treguar shoqet e saj. Është kryer menjëherë kontrolli gjinekologjik ndaj saj, dhe është konstatuar se nuk ka lëndime të dukshme dhe janë marrë mostra për analizë të mëtejme. I dyshuari është arrestuar në Stacionin Policor në Tetovë dhe është njoftuar edhe prokurori publik. Janë marrë masa për zbardhjen e plotë të rastit.

Arrestohet një tetovar, kërkohet me urdhër gjykate

Pjesëtarë të policisë së Sektorit për Punë të Brendshme në Tetovë dje rreth orës 12 e kanë arrestuar 65 vjeçar R.D nga fshati Saraqinë për të mbajtur dënimin me burg prej një viti. Pas arrestimit të realizuar me urdhër të gjykatës, pas mbajtjes së shkurtër është dërguar në burgun e Tetovës.

Lëndohen rëndë tre këmbësorë në Shkup

Tre këmbësorë janë lënduar më rëndë në dy prej gjithsej 13-të aksidenteve të regjistruara gjatë ditës së djeshme në rajonin e SPB Shkup. Në pesë aksidente janë lënduar më lehtë pesë persona, ndërsa në gjashtë është shkaktuar dëm material. Nga MPB informojnë se dje policia rrugore ka zbuluar dhe sanksionuar një numër të madh kundërvajtjesh. Njëzetë e tre shoferë kanë drejtuar automjetin me shpejtësi më të madhe se e lejuara, pesë shoferë kanë kaluar në udhëkryq në dritë të kuqe të semaforit dhe dy shoferë për rreshtim të parregullt. Nga komunikacioni janë përjashtuar dy shoferë të cilët e kanë drejtuar automjetin nën ndikim të alkoolit, dhjetë shoferë para se të përfitojnë të drejtën e drejtimit të automjetit motorizues dhe 11 automjete të paregjistruara. Është sanksionuar edhe një këmbësor që ka kaluar jashtë vendkalimit për këmbësorë. Janë hasur edhe 92 automjete të parkuara në mënyrë të parregullt. Me ndihmën e automjetit të posaçëm të karrotrecit janë larguar 94 automjete. (U.H)

Një bullgar kapet me 17.6 kg marihuanë

Kumanovë, 26 janar - Është caktuar paraburgim 30-ditor për një shtetas bullgar në automobilin e të cilit mbrëmë në VK "Tabanoc" për dalje nga Maqedonia janë gjetur 17.6 kilogramë marihuanë, e dedikuar për shitje. Prokuroria Themelore Publike Kumanovë duke vepruar për kalëzimin e dorëzuar penal solli urdhër për zbatim të procedurës hetuese kundër shtetasit bullgar për vepër penale "prodhimtari e paautorizuar dhe lëshim në qarkullim të drogave narkotike, substancave psicotropikale dhe prekursorëve" nga neni 215 paragrafi 1 nga KP. Siç infor-

mojnë nga Prokuroria Publike, dje në orën 00:15, në VK "Tabanoc", në dalje nga Maqedonia për hyrje në Serbi gjatë kontrollit të automjetit të udhëtarëve "Pezho" 807 me targa bullgare është zbuluar një bunker me 71 pako marihuanë. Bunkeri është bërë në dyshemenë e automjetit afër sediljeve të pasme. Marihuana me neto peshë të përgjithshme prej 17.665,5 gramë, është paketuar në material bimor dhe vakuum qese polietilike e mbështjellë me celfan elastik dhe transparent. I dyshuari drogën e ka transportuar për shitje. "Duke i pasur pa-

rasysh rrethanat, si dhe peshën e vepërës penale dhe dënimit të paraparë, prokurori publik kompetent vlerësoi se janë përmbushur kushtet për përcaktim të masës paraburgim nga neni 165 paragrafi 1 pika.1 dhe 3 nga Ligji për procedurë penale. Nga këto arsye, deri te gjykatësi i procedurës paraprake pranë Gjykatës Themelore Kumanovë është dorëzuar Propozim për përcaktim masë paraburgim e cila është pranuar dhe me Vendim të dyshuarit i është shqiptuar paraburgim në kohëzgjatje prej 30 ditësh", thuhet në kumtesë. (O.XH)



Ofertat atraktive në transportin ajror (fluturime me çmime të volitshme, hyrja e më shumë kompanive ajrore të reja, mbështetja e fuqishme e qeverive të rajonit për zhvillimin dhe modernizimin e aeroporteve, si dhe subvencionimi i kompanive lou kost), kanë ndikuar në rritjen e numrit të udhëtarëve që parapëlqejnë më tepër avionët se sa autobusët

Koha Fisnik PASHOLLI

Shkup, 26 janar - Aeroportet në rajon shënojnë rritje të madhe të transportit të udhëtarëve në vitet e fundit. Kjo u arrit falë masave dhe politikave të reja që nënkuptojnë fluturime me çmime të volitshme, hyrja e më shumë kompanive ajrore të reja, mbështetja e fuqishme e qeverive të rajonit për zhvillimin e transportit ajror, si dhe subvencionimi i kompanive lou kost që vendosën destinacione të reja, por edhe me angazhimi i koncesionarëve të aeroporteve në rajon që modernizuan dhe përmirësuan dukshëm kushtet e punës në aeroportet e rajonit.

Të dhënat tregojnë se bile 9 aeroporte në rajon kanë transportuar më shumë se një milion pasagjerë, përkundër vlerësimit të ekspertëve

TRANSPORTI I UDHËTARËVE NË RAJON

MË LIRË ME AVION SE ME AUTOBUS



të aviacionit se qarkullimi vjetor edhe me 300 mijë udhëtarë është i mjaftueshëm për punë të pavarur dhe mbijetesë në tregun me konkurrencë të madhe.

Në kohën dinamike që jetojmë sot, kur koha dhe të hollat janë një resurs i çmuar, duket se transporti me avion është më efikas për të arritur më shpejtë deri te një destinacion. Me rritjen e fluturimeve të lira si dhe prezencën në treg të kompanive ajrore që vet ekzistencën dhe punën e tyre e bazojnë në shërbimet e lira, por edhe me shtimin mërgimtarëve nga rajoni që punojnë dhe jetojnë jashtë vendlindjes, shënohet edhe rritja e madhe e transportit ajror në periudhën e fundit.

Sa i përket aeroporteve të rajonit, ai i Beogradit edhe më tej është

i pari me 5.34 milionë udhëtarë në vitin 2017, ndërsa dy herë më pak udhëtarë kanë aeroportet në Zagreb dhe Split. Aeroporti i Shkupit vitin e kaluar ka transportuar 1.868.272 pasagjerë, duke u renditur në vendin e gjashtë, falë preferencave të qytetarëve për të udhëtuar me kompani që ofrojnë çmime të lira. Këtë e dëshmon edhe fakti se kompania që ofron fluturime të lira në tërë Evropën, Wizz Air, ka transportuar një numër rekord prej 1.2 milion udhëtarësh nga dhe prej Maqedonisë, duke shënuar një rritje prej 32 për qind në raport me vitin 2016, tregojnë analizat e portalit "Exyaviation".

Në Serbi, Wizz Air ka transportuar 745.000 pasagjerë, ndërsa në Bosnje e Hercegovinë ka transportuar 583.000 pasagjerë apo dyfi-

shin më shumë se në vitin 2016.

Në ndërkohë, para Shkupit në vendin e pestë është renditur aeroporti ndërkombëtar i Prishtinës "Adem Jashari" me 1.887.402 udhëtarë në vitin e kaluar. Edhe pse kosovarët mbesin të izoluar për shkak të mungesës së liberalizimit të vizave, Prishtina megjithatë ia ka kaluar Shkupit me numrin e udhëtarëve. Sivjet Aeroporti i Prishtinës planifikon që t'i përfshijë edhe udhëtimet për vendet skandinave dhe t'i zgjerojë pistat. Me rritjen e numrit të fluturimeve dhe çmimet e arsyeshme, "Adem Jashari" në vitin 2018, pritet të arrijë shifrën prej 2 milionë udhëtarë. Nëse i referohemi të dhënave të statistikës shtetërore për vitin 2016, del se nga Aeroporti i Tiranës "Nënë Tereza" vetëm në vitin 2016 kanë

fluturuar 2.139.434 milion udhëtarë, me çka ky aeroport ka më shumë udhëtarë se Prishtina apo Shkupi, përkundër çmimeve shumë më të shtrenjta në raport me aeroportet e rajonit. Por, edhe pse Shqipëria posedon një potencial të madh të turizmit, ajo ka numrin më të ulët të fluturimeve krahasuar me aeroportet e vendeve të Ballkanit, si dhe mbetet aeroporti me çmimet më të larta në rajon. Pritet që pas tre vitesh Shqipëria të fitojë edhe një aeroport të ri në Vlorë. Merret vesh se tri kompani turke kanë paraqitur në Ministrinë e Infrastrukturës një ofertë për të ndërtuar Aeroportin e Vlorës. Ndër to është edhe Konsorciumi që po ndërton aeroportin më të madh në botë, atë të Stambollit me vlerë 22 miliardë euro.

KUR LIGJI NUK JEP ALTERNATIVA TË TJERA

Shtimi i nivelit të rrogave të mësimdhënësve përmes kontributeve nga komuna, sipërmarrësit apo alternativave të ngjashme - nga shumë persona shihet si mënyrë mjaft e mirë për rritjen e cilësisë dhe konkurrencës brenda këtij profesioni. Ai model në mënyrë të drejtpërdrejtë do të ndikonte edhe në konkurrencën mes komunave në kuptimin se kush prej tyre do të tregohet më i ndjeshëm ndaj arsimit dhe mësimdhënësve, por do të shtonte edhe motivin e këtyre të fundit për profesionalizëm dhe kualifikime të reja

Rrogat e mësimdhënësve vetëm nga Qeveria

Koha Laura PAPANIKU

Shkup, 26 janar - Aksioma "nuk ka reforma pa para", sigurisht se është e vlefshme edhe për arsimin, nëse jo edhe pak më tepër nisur nga sensitiviteti që ka arsimi dhe ndikimin që ka cilësia e saj në të gjitha sferat tjera. Këtë vit, sikurse është paralajmëruar - do të ketë rritje prej 5 për qind të rrogave të punësuarve në arsim, por pavarësisht kësaj - mësuesit, arsimtarët dhe profesorët e Maqedonisë vështirë se do të barazohen me kolegët e tyre nga Kosova, Shqipëria, Serbia e kështu me radhë. Mësimdhënësit pritet të marrin përafërsisht nga 1100 denarë më tepër rrogë krahasuar me pagat e tanishme. Megjithatë, rrogat e tyre janë të limituara vetëm në kornizat e buxhetit të caktuar paraprakisht nga Qeveria, pasi për momentin - janë të mbyllura mundësitë që pagat e tyre të plotësohen edhe nga burime të tjera. Pra, pavarësisht shkollës në të cilën mund të punojnë dhe komunën në të cilat gravitojnë, rrogat janë të

njëta. Pak rëndësi ka nëse zona ku vepron një shkollë është e favorizuar, karakterizohet nga mirëqenia e kalueshme sociale apo ndodhet në zonë të pafavorizuar financiarisht. Sipërmarrës që mund të ofrojnë kontribute financiare edhe po të gjenden nuk mund të ndihmojnë në rritjen e rrogave të mësimdhënësve. Niveli i tyre përcaktohet ekskluzivisht nga buxheti. Rritja e rrogave të arsimtarëve nuk mund të ndodhë përmes kontributeve shtesë apo rritjeve alternative, pasi kjo është e ndaluar me Ligj. Konkretisht, Ligjin për arsim të mesëm në pjesën e cila rregullon çështjen e financimit të shkollave në mënyrë taksative u ndalon komunave të participojnë në rritjen e rrogave të mësimdhënësve. Ata mund të ndihmojnë financiarisht shkollat në pika të tjera si investime, mirëmbajtje apo realizim projektesh. "Komunat mund ta plotësojnë bllok-dotacionin e marrë, respektivisht dotacionin e dedikuar për arsim me mjete nga burime vetanake, në përjashtim të rrogave të punësuarve në shkolla",

thuhet në nenin 101-A të Ligjit për arsim të mesëm. Ndërkaq, me nenin paraprak sqarohen në detaje mënyrat e financimit të shkollave, ku sikurse qëndron në paragrafin e parë të nenit 101, "mjetet për financimin e shkollave publike sigurohen vetëm nga buxheti i shtetit", dhe siç sqaron paragrafi i dytë i po këtij neni - "mjetet financiare u shpërndahen komunave përmes bllok-dotacioneve dhe dotacioneve të dedikuara në pajtim me Rregulloren dhe metodologjinë për vërtetimin e kriterëve për shpërndarjen e bllok dotacioneve, sipas Ligjit për financimin e njësive të vetë administrimit lokal". Në paragrafët pasuese të këtij neni tregohet mënyra se si komunat bëjnë shpërndarjen e bllok-dotacioneve, të cilat sigurohen nga buxheti në përputhshmëri me standarde dhe normat përkatëse. Komunat, pra mund të plotësojnë bllok-dotacionet e shkollave për mirëmbajtjen e objekteve, për rritjen e standardit të mësimin apo edhe për blerjen e pajisjeve të punës, mirëpo nuk mund të

ndikojnë në rritjen e rrogave të mësimdhënësve. Krijimi i alternativave të tjera për rritjen e rrogave të punësuarve në arsim, sidomos të mësimdhënësve, nga shumë persona shihet si mënyrë mjaft e mirë për rritjen e cilësisë dhe konkurrencës brenda këtij profesioni. Në mënyrë të drejtpërdrejtë kjo do të ndikonte edhe në konkurrencën mes komunave, në kuptimin se cila prej tyre është më shumë e ndjeshme ndaj arsimit, konkretisht mësimdhënësve. Natyrisht që shpirti i konkurrencës do të reflektohej edhe te këta të fundit, pasi kuadri me më tepër të kualifikuar do të "luftonte" për t'u punësuar në një shkollë e cila ofron rroga më të mira. Aktualisht, rroga më e lartë e një mësimdhënësi në arsimin parauniversitar, pra e një profesori në prag të pensionit, nuk arrin as nivelin e 24 mijë denarëve. Gjithë të tjerët kanë rroga ende më të ulëta se ta. Në këtë drejtim, Maqedonisë ia kanë kaluar të gjitha shtetet e rajonit, duke mos përjashtuar as Kosovën, shtetin më të ri të Evropës.

PUBLIKOHET INDEKSI GLOBAL EKOLOGJIK

MAQEDONIA NDËR SHTETET MË TË NDOTURA NË RAJON

Analizat e EPI apo Indeksit Botëror të Ambientit për 180 shtete tregojnë se Bosnjë e Hercegovina është shteti më i ndotur në rajon. Maqedonia në vendin e 68 në botë ka rezultatet më të dobëta vetëm se Bosnja në vendin e 158 dhe Serbia që renditet në vendin e 84

Koha

Fisnik PASHOLLI

Shkup, 26 janar - Maqedonia renditet ndër shtetet me më shumë probleme me ndotjen e ajrit nga shtetet e rajonit. Analizat e EPI apo Indeksit Botëror të Ambientit tregojnë se Bosnje e Hercegovina është shteti më i ndotur në rajon, duke u renditur në vendin e 158-të në botë nga 180 shtete. Maqedonia në vendin e 68 ka rezultatet më të dobëta vetëm se Bosnja dhe Serbia që renditet në vendin e 84. Ndotja e ajrit, sipas ambientalistëve, është një vrasës i padukshëm. Organizata Botërore e Shëndetësisë vlerëson se mbi 7 milionë vdekje në vit në botë ndërlihen me cilësinë e keqe të ajrit. Sipas indeksit më të ri për vitin 2018 të EPI-t, ndotja e ajrit paraqet kërcënimin më të madh nga ambienti për shëndetin e njeriut.

EPI, që si indeks përgatitet nga universitetet më të mira amerikane, por edhe botërore - Yale dhe Columbia në bashkëpunim me Forumin Botëror Ekonomik, rendit 180 shtete sipas 24 treguesve në 10 kategori si cilësia e ajrit, metalet e rënda, ndotja e ajrit, klima dhe energjia,

resurset e ujit... që në fund ndikojnë në shëndetin e njeriut, ambientin dhe ekosistemin. Analizat e EPI-it tregojnë se nga shtetet e tjera të rajonit, e para është Greqia në vendin e 22-të. Bullgaria është e 30-a, Sllovenia në vendin e 34, Shqipëria renditet në vendin e 40-të, Kroacia është në vendin e 41, dhe Mali i Zi në vendin e 65. Në listën e shteteve më efikase lidhur me mbrojtjen e ambientit dhe ajrit më të pastër janë Zvicra, Franca, Danimarka, Malta dhe Suedia. Rezultatet më të dobëta i kanë India, Bangladeshi, Burundi, Kongo dhe Nepali. Sipas Daniel Esit, drejtorit të Qendrës së Yale për legjislacion dhe politikën e mbrojtjes së ambientit, politikanët duhet të dinë se kush udhëheq dhe kush ngec në raport me sfidat energjetike dhe ekologjike, për shkak se komuniteti botëror përpjeket të realizojë qëllimet e zhvillimit të qëndrueshëm. "EPI 2018 konfirmon se suksesi në aspekt të zhvillimit të qëndrueshëm kërkon edhe përparim ekonomik që sjell mjete për investim në infrastrukturën e mbrojtjes së ambientit dhe menaxhimin e kujdesshëm me industrializimin dhe urbanizimin që

çojnë drejt ambientit jo të pastër dhe kërcënojnë shëndetin publik dhe ekosistemet", thekson Esit.

Në ndërkohë, në Maqedoni në konkursin për zgjidhje inovative për uljen e ndotjes së ajrit, disa kompani kanë fituar mjete nga Fondi për Inovacion dhe Zhvillim në bazë të thirrjes "O2".

"Eko Solar" nga Shtipi është shpërblyer për zgjidhjen teknologjike për kolektorin solar ajror që ngroh ajrin me ndihmën e diellit dhe ndihmon në ngrohjen e ambienteve. "Bizifaj" nga Manastirit ndërkohë do të përgatisë lëng me të cilin do të absorbohen grimcat e dëmshme në ajër PM. "Parku teknologjik" nga Tetova do të fitojë mjete për përgatitjen e biznes modeleve për investime në ndërrimin e sistemeve të vjetra në amvisëri me të reja.

"Tehnoben Nova" nga Prilepi do të subvencionohet për prodhimin e aparatit që mundëson filtrimin e gazrave që lëshohen në objekte të caktuara industriale, ndërsa "Veni-

to Komerç" nga Kavadari do të zhvillojë biçikletë elektrike që do të përdoret në qytet me filtra të instaluar për pastrimin e ajrit. Në ndërkohë, vitet e fundit ndër problemet kryesore në Maqedoni është ndotja e ajrit. Përkundër masave të ndryshme afatshkurtra dhe afatmesme - deri tani nuk ka është arritur ndonjë rezultat më i madh në uljen e ndotjes. Analizat tregojnë se ajri dhe toka bujqësore e ndotur së bashku me mungesën e informacioneve të sakta të burimeve të ndryshme të ndotjes dhe zgjidhja e problemit të ndotjes jo në mënyrë parciais, por të përgjithshme janë problemet kryesore të mbrojtjes së ambientit që brengosin qytetarët në vend. Gjithashtu, edhe mungesa e mbikëqyrjes së ndryshimeve në ambient dhe statistikës së saktë pamundësojnë në mos zgjidhjen atëherë së paku zbutjen e ndotjes. Problem tjetër është edhe mungesa e të hollave për investime më të mëdha në sektorin e ambientit jetësor

Në Gjykatë arrijnë 100 kërkesat e para për amnisti

Shkup, 26 janar - Në Gjykatën penale dhe nga burgjet kanë arritur midis 50 dhe 100 kërkesa për të cilat Gjykata do të veprojë në pajtim me Ligjin për amnisti, informoi kryetari i Gjykatës Themelore, Ivan Xholev, në brifing me gazetarët. Deri te Gjykata, siç tha, pritet të arrijnë rreth 1.500 kërkesa për amnisti, nga të cilat 500 për lirim të plotë të personave të dënuar, ndërsa 1.000 të tjerët për amnisti të pjesshëm. Xholev informoi se në Gjykatë tashmë janë informuar më shumë këshilla penale të cilat do të vendosin për kërkesat për amnisti dhe se shpreson se Gjykata do të përgjigjet në afatin e paraparë. "Formuam këshilla penale që të mund ta ruajmë afatin prej pesë ditëve në të cilin duhet Gjykata të deklarohet për kërkesat nga burgjet.

Me aktin për amnisti, Gjykata penale duhet të konfirmojë se ndonjë person i dënuar i plotëson kushtet për amnisti", tha Xholev. Gjykata, vendimet duhet t'i dërgojë deri te Ministria e Drejtësisë dhe prej atje deri te Drejtoria për Kryerjen e Sanksioneve.

Nga Drejtoria për Kryerjen e Sanksioneve për MIA-n deklaruan se shpejtësia e daljes së të amnistuarve varet nga gjykatat. Prej atje shtojnë se janë përgatitur për dorëzimin e të gjitha zgjidhjeve që i lirojnë personat e dënuar nga vuajtja e dënimit me burg. Ligji për amnisti prej dhe ka hyrë në fuqi.

BUJQIT PËR UDHËHEQJEN NGA VITI 2013 DERI NË VITIN 2016

"Dysh" për Ministrinë e Bujqësisë

Shkup, 26 janar - Bujqit pothuajse aspak nuk ishin të kënaqur nga shërbimet dhe transparenca e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave në periudhën nga viti 2013 deri në vitin 2016, tregojnë rezultatet nga hulumtimi i zbatuar i "Koalicionit rural".

Nga numri i përgjithshëm i të anketuarve madje 45 për qind i kanë vlerësuar me notën "dysh" shërbimet e Ministrisë, ndërsa 19

për qind me "njësh". Hulumtimi tregoi se edhe pjesa më e madhe e bujqve nuk kanë dijeni ose nuk kanë informacion se mund të përfshihen në punën e Ministrisë, ndërsa vetëm tre për qind e të anketuarve theksuan se kanë marrë pjesë në punën e ndonjëris nga grupet nënsektoriale në Ministrinë dikasteriale.

Përqindja është e lartë, madje 88 për qind dhe e atyre të cilët aspak nuk janë në dijeni për ekzi-

stimin e programeve vjetore për punën e Ministrisë së Bujqësisë. "Është e nevojshme të ndryshojë tërë procesi i krijimit të programeve, gjegjësisht fillimisht të organizohen takime lokale në të cilat bujqit do të tregojnë çka ju duhet dhe çfarë ndryshime janë të nevojshme në programet dhe madje më pas në nivel kombëtar të bisedohet për programin", theksoi Liljana Jonoski, projekt koordinuese dhe drejtoreshë ek-

zekutive e "Koalicionit rural" në prezantimin e sotëm të rezultateve nga hulumtimi.

Sekretari shtetëror në Ministrinë e Bujqësisë, Nefrus Çeliku, paralajmëroi se konkludimet dhe vërejtjet nga hulumtimi do të merren parasysh, por theksoi se tani punët kanë ndryshuar dhe se çdo ditë azhurnohet ueb faja e Ministrisë. "Janë vendosur 21 dokumente dhe do të vendosen ende informacione dhe doku-

mente me karakter publik. Para Vitit të Ri shpallëm një thirrje publike deri te të gjitha shoqatat civile që të paraqiten për anëtarësim në grupet nënsektoriale të Ministrisë dhe çdo shpallje për tokë shtetërore bujqësore publikohet në ueb faqe", tha Çeliku. Me këtë hulumtim janë përfshirë 400 bujq nga të gjithë tetë rajonet planore në shtet dhe 10 persona të punësuar në Ministrinë e Bujqësisë.

Arifi ka mohuar se zjarrfikësit e Tetovës janë dy muaj pa rroga, duke nënvizuar se sistemi financiar është funksional që prej ditës së sotme. Në ndërkohë, ajo ka theksuar se ende janë duke zhvilluar bisedime për të krijuar shumicën në Këshillin e komunës dhe për të zgjedhur kryetarin e Këshillit

VONESA E PAGAVE, REVOLTOHEN MËSIMDHËNËSIT

TETOVA ENDE PA KRYETAR KËSHILLI



Koha Urim HASIPI

Tetovë, 26 janar - Edhe gjatë ditës së sotme (premtë) nëpër disa shkolla të mesme në orët e mëngjesit ka patur bojkot të mësimet për shkak të mos lëshimit të rrogave dhe vonesave për shkak të problemeve me zgjedhjen e kryetarit të Këshillit të Komunës së Tetovës. Ndonëse të martën Qeveria obligoi Ministrinë e Financave që të lexojë buxhetet e Komunës së Çairit, Tetovës, Tearcës dhe Kostivarit megjithatë profesorët nëpër shkollat e mesme që nuk kanë marrë pagat

kanë bojkotuar mësimin në shenjë revolte. Kryetarja e Komunës së Tetovës, Teuta Arifi, tha se që nga dita e djeshme ka filluar me pagesa dhe e njëjta vazhdon, ndërsa nënvizoi se "Këshilli komunal i Tetovës, ashtu siç e keni parë dhe ju, para 31 dhjetorit ka votuar Buxhetin me shumicë votash, pikërisht për të mos e lejuar që qytetarët dhe të gjithë ta të cilët janë të lidhura me pagesa administrative mos kenë problem të kësaj natyre". Ministria e Financave gjatë dy javëve të para nuk e

ka lexuar buxhetin dhe që është shkaktuar vonesë lidhur, jo për shkak të vendimit që ne kemi sjellë në kohë, po për shkak të leximit të vonuar. Ditën e martë, pra këtë të martë Qeveria ka sjellë një konkluzë, ku ka kërkuar që Ministria e Financave të lexojë buxhetin, buxheti ynë është lexuar dje dhe që dje ka filluar po ashtu janë lëshuar edhe vlerësimi i rrogave për arsimtarët dhe në të njëjtën kohë për administratën dhe të gjitha institucionet e tjera edhe nëse ka ndonjë pakënaqësi - ato adresën e

kanë diku tjetër, sigurisht nuk e ka në Komunën e Tetovës", deklaroi Teuta Arifi, kryetare e Komunës së Tetovës. Ajo ka mohuar se zjarrfikësit e Tetovës janë dy muaj pa rroga, duke nënvizuar se sistemi financiar është funksional që prej ditës së sotme. "Nuk janë dy muaj pa rroga, pra rrogën e fundit e kanë marrë në muajin dhjetor, kurse rrogën tjetër e marrin këtë vit - në muajin janar. Nuk kanë qenë asnjëherë pa rroga as zjarrfikësit, as administrata dhe askush tjetër. Është një problem administrative dhe e dini që ka të bëjë me buxhetin, edhe atëherë thash edhe përsëri ju falënderohem këshilltarëve të komunës së Tetovës që pavarësisht bindjeve politike, vendosën të mbështesin buxhetin me qëllim qoftë pak edhe me vonesë, po sistemi të funksionojë. Sistemi financiar është funksional që prej sot në mëngjes", tha kryetarja Arifi. Në ndërkohë, ajo ka theksuar se ende janë duke zhvilluar bisedime për të krijuar shumicën në Këshillin e Komunës dhe për të zgjedhur kryetarin e Këshillit.

"Ne do ti vazhdojmë bisedi-

met tona ndërmjet grupeve të këshilltarëve edhe besoj që në atmosferën e marrëveshjes dhe mirëkuptimit, siç e kemi pasur edhe gjatë tërë këtyre muajve, pa marrë parasysh që nuk kemi pasur të zgjedhur kryetar këshilli, dhe tani të bëjmë një zgjedhje që do ta bëjë akoma më aktiv Këshillin e komunës", tha ajo. Ndërkaq, lidhur me seancën e jashtëzakonshme me të cilën ka udhëhequr këshilltari Adnan Bilalli, i cili pasi u zgjodh kryetar këshilli, komuna anuloi vendimin, kryetarja Arifi sqaroi se deri në zgjedhjen e kryetarit të Këshillit me seancat udhëheq këshilltari më i vjetër. "Njoftimet vijne gjithmonë me emrin dhe mbiemrin e kryesuesit më të moshuar dhe kryesuesi më i moshuar është ai që thërret mbledhjet deri në zgjedhjen e kryesuesit. Në thirrjet për Këshill ai shkruhet si kryesues më i moshuar dhe jo si kryetar. Ne atëherë e bëjmë të qartë se kishim mungesë të një vote që nuk parashihej ligjërisht dhe normal nuk deshëm të bëjmë të ligjshme diçka që nuk ishte komplet në suaza të ligjit", deklaroi Arifi.

Publicitet

Në bazë të nenit 150 nga Ligji për sigurim shëndetësor (Gaz. zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 43/12, 145/12, 87/13, 164/13, 39/14, 43/14, 132/14, 188/14, 10/15, 61/15, 154/15, 192/15, 17/16 dhe 37/16), neni 13 nga Rregullorja për specializimet dhe subspecializimet të punëtorëve shëndetësor me arsimim të lartë nga fusha e medicinës (Gaz. zyrtare e RM nr. 85/15) dhe neni 6 nga Rregullorja për specializimet dhe subspecializimet të punëtorëve shëndetësor dhe bashkëpunëtorëve shëndetësorë me arsimim të lartë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 137/12 dhe 121/13), Fakulteti i mjekësisë pranë Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup shpall:

Plotësim të

Shpalljes publike për paraqitje të kandidatëve për regjistrim gjegjësisht lejim të specializimit dhe subspecializimit të punëtorëve shëndetësor dhe bashkëpunëtorëve shëndetësor me arsim sipëror nga sfera e medicinës për vitin 2018

Nr. rend.	Specializim	Për të punësuar shëndetësor gjegjësisht bashkëpunëtor shëndetësor të punësuar në Institucionet private, persona tjerë juridik dhe të papunësuar
1	Dermatovenerologjia	3
2	Oftalmologjia	2
3	Patologjia	2
4	Gastroenterohepatologjia	1

Nr. rend.	Subspecializim	Për të punësuar shëndetësor gjegjësisht bashkëpunëtor shëndetësor të punësuar në Institucionet private, persona tjerë juridik dhe të papunësuar
1	Kirurgjia vaskulare	1

Kërkesa për miratim të specializimeve së bashku me dokumentacionin e kompletuar dorëzohet nga ana e Institucionit privat shëndetësor në të cilën është i punësuar punonjësi shëndetësor, gjegjësisht nga punëtori shëndetësor i papunësuar apo bashkëpunëtori shëndetësor, në pajtim me dispozitat nga Ligji për mbrojtje shëndetësore dhe Rregullorja për specializimet dhe subspecializimet të punëtorëve shëndetësor dhe bashkëpunëtorëve shëndetësor me arsim sipëror dhe Rregullorja për specializimet dhe subspecializimet të punëtorëve shëndetësor me arsim sipëror nga sfera e medicinës më së voni në afat prej 15 ditëve nga dita e publikimit të Shpalljes, deri në arkivin e Fakultetit të mjekësisë pranë Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup, rr. "50-ta Divizija" nr. 6, 1000 Shkup.

Ligji për mbrojtje shëndetësore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 43/12, 145/12, 87/13, 164/13, 39/14, 43/14, 132/14, 188/14, 10/15, 61/15, 154/15, 192/15, 17/16 dhe 37/16) dhe Rregullorja për specializimet dhe subspecializimet të punëtorëve shëndetësor me arsim sipëror nga sfera e medicinës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 85/15) mund të gjenden në ueb faqen e Fakultetit të mjekësisë www.medf.ukim.edu.mk.

UNIVERSITETI "SHËN KIRILI DHE METODI"
FAKULTETI I MJEKËSISË - SHKUP

Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 pika 1, paragrafi 2 dhe paragrafi 3 dhe neni 23 të Ligjit për marrëdhënie pune - Teksti i pastruar ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 167/15), neni 60 paragrafi 1, 2 dhe 3 dhe neni 62 paragrafi 1 alineja 1 dhe 2 e Ligjit për arsim të mesëm ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 44/95, 34/96, 35/97, 82/99, 29/02, 40/03, 67/04, 55/05, 113/05, 35/06, 30/07, 49/07, 81/08, 92/08, 33/10, 116/10, 156/10, 18/11, 42/11, 51/11, 6/2012, 100/12, 24/13, 44/14, 116/14, 24/13, 44/14, 116/14, 135/14, 10/15, 145/15, 30/16, 127/16 dhe 67/17), u. d. Drejtori i shkollës së mesme komunale Gjinnazi "Mirçe Acev" - Prilep publikon

SHPALLJE PUBLIKE

Për pranimin e mësimdhënësit - për kohë të caktuar të punës deri më 31.08.2018

- Mësimdhënës të biologjisë me 40 orë punë deri në ndërprerjen e pushimit të lindjes së mësimdhënësës Sofija Krsteska, gjegjësisht deri më 31.08.2018..... 1 realizues

Kushtet:

- Kushtet e përgjithshme - të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë
- Kushtet e posaçme - të ketë arsim përkatës

Kandidatët krahas fletëparaqitjes, duhet të dorëzojnë edhe dokumentet në vijim:

- diplomë për mbarim të së paku katër vjet të arsimit përkatës sipëror dhe ka fituar së paku 240 kredi sipas SETK (origjinal ose kopje të vërtetuara në noter)
- certifikatë të shtetësisë
- njëh gjuhën standarde maqedonase dhe gjuhën standarde në të cilën zhvillohet mësimi.

Kandidatët me numër rendor 1 të kenë të mbaruar së paku katër vjet të arsimit përkatës sipëror dhe kanë fituar së paku 240 kredi sipas SETK dhe të njohin gjuhën standarde maqedonase dhe gjuhën standarde në të cilën zhvillohet mësimi.

Orari i punës për kandidatët me numër rendor 1 të cilët do të zgjidhen përmes shpalljes do të fillojë prej ora 7³⁰ deri më 13³⁰, ndërsa në ndërrimin e pasdites pre ora 13³⁰ deri më 19³⁰ në pajtim me orarin e orëve. Pagesa bazë është 21.500,00 denarë.

Shpallja zgjatë 5 (pesë) ditë pune.

Zgjedhja do të realizohet në afat prej 15 ditëve pas kalimit të afatit për parashtrimin e dokumenteve të nevojshme.

Fletëparaqitjet me dokumentet e nevojshme të dorëzohen në adresën në vijim: Shkolla e mesme komunale Gjinnazi "Mirçe Acev" - Prilep, rr. "Prilepski braniteli" numër 96a, 7500 Prilep.

Dokumentet e dorëzuara pas afatit dhe të pakompletuara nuk do të merren parasysh.

U. D Drejtor
Dimçe Nastoski

LAJMËRIM

Fakulteti juridik "JUSTINIANI I PARË" në Shkup, informon se më datë 5.02.2018 (e hënë) në ora 12, kandidatja m-r Marija Grozdanovska do të mbrojë disertacionin e doktoratës me temë: "Aplikimi i marrëveshjes së llojit dhe shkallës së sanksionit për kundërvajtje në Republikën e Maqedonisë"

Mbrojta do të bëhet në sallën e takimeve të Fakultetit juridik "Justiniani i Parë" - Shkup, bul. "Goce Dellçev" 9b - Shkup (salla për tmm nën dekanat)

Nga Fakulteti juridik "JUSTINIANI I PARË" Shkup

URGJENTISHT

Shitet shtëpi në lagjen Serava-Shkup në rr. "7 korriku" nr. 8 afër spitalit gjinekologjik, shtëpia është e ndërtimit të ri me dokumentacion të kompletuar. Kontakt tel. 070-775-703; 071 372 221

TRE DITË ZIE
NË TETOVË

Në emër të nxënësve të shkollës fillore "Goce Dellçev", ku mësimet i kanë ndjekur edhe dy djemtë dhe vajza e Musa Zylbearit, referat lexoi nxënësja Jesmina Pajaziti, e cila nënvizoi se këtë vdekje të shokëve dhe shoqes së shkollës e kanë përjetuar shumë rëndë



VARROSET NËNA ME KATËR FËMIJË

Koha Urim HASIPI

Tetovë, 26 janar - Mijëra qytetarë kanë marrë pjesë në ceremoninë e varrimit të katër fëmijëve dhe nënës së tyre, të cilët humbën jetën në orët e hershme të mëngjesit të ditës së djeshme pas një zjarri të përmasave të mëdha që kaploi shtëpinë e tyre në rrugën "Goce Dellçev" në Tetovë. Ceremonia e varrimit është zhvilluar në varrezat e Tetovës, ku familjarë, të afërm, arsimtarë, nxënës, dhe qytetarë të shumtë nga të gjitha qytetet e Maqedonisë me nderime fetare, mes lotëve dhe dhimbjes së madhe - kanë nderuar pesë kufomat, katër fëmijët dhe nënën në rrugëtimin e tyre drejt banesës së fundit. Myftiu i Myftinisë së Tetovës, Qani efendi Nesimi pjesëmarrës në ceremoninë e varrimit, pas ngushëllimeve që shprehu për familjen dhe lutjeve për tanimë të ndjerët, tha se vdekja dhe varri janë pjesë e jetës që jetojmë ne, sepse të gjithë ne jemi të vdekshëm nuk jemi të përjetshëm, dhe një ditë që të gjithë do të vdesim. Në emër të nxënësve të shkollës fillore "Goce Dellçev", ku mësimet i kanë ndjekur edhe dy djemtë dhe vajza e Musa Zylbearit, referat lexoi nxënësja Jesmina Pajaziti, e cila nënvizoi se këtë vdekje të shokëve dhe shoqes së shkollës e kanë përjetuar shumë rëndë. Në ndërkohë, në orët e paradites këtë të premte me vendim të Këshillit të komunës së Tetovës, është shpallur tre ditë zi edhe atë duke përfshirë ditën e djeshme, ditën e shtunë dhe të dielën. Me këtë rast, edhe flamujt para Komunës së Tetovës janë ulur në gjysmë shtizë. Vendi-



QEVERIA AKORDON 300 MIJË DENARË PËR FAMILJEN ZYLBEARI
Ndhimë financiare prej 300 mijë denarëve do t'ia akordojë Qeveria familjes Zylbeari nga Tetova në shtëpinë e të cilit dy ditë më parë shpërtheu zjarr dhe humbi jetën nëna dhe katër fëmijët e saj minorenë. "E nxitur nga ngjarja tragjike në lagjen Potok të Tetovës, Qeveria e Republikës së Maqedonisë dje e konvokoi seancën e 51-të dhe mori konkluzion për akordim të ndihmës financiare. Krahas ndihmës në para në vlerë prej 300 mijë denarëve për familjen Zylbeari, në seancë është kontraktuar që një delegacion qeveritar t'i vizitojë familjen dhe nga afër ta shpreh ngushëllimin e thellë për këtë tragjedi", thuhet në kumtesën e Qeverisë.



mi është marrë me shumicë votash, në seancën e jashtëzakonshme për rastin tragjik të familjes Zylbeari ku humbën jetën pesë anëtarë të kësaj familje gjatë zjarrit që kaploi shtëpinë e tyre ditën e djeshme. Në seancën e djeshme po ashtu është vendosur që kjo familje të ndihmohet me 2 milionë denarë apo 32 mijë euro ndihmë për rindërtimin e shtëpisë. Në seancë raport të mbi intervenimin e djeshëm ka dhënë udhëheqësi i brigadës së zjarrfikësve, Uka Aliti. "Njësia kundër zjarrit menjëherë pas paraqitjes së rastit ora 4 e 15 minuta nga e Policisë së Tetovës ka intervenuar në vendngjarje me 13 zjarrfikës dhe katër automjete me ç'rast është parandaluar përhapja

e zjarrit edhe në shtëpitë përreth. Si pasojë e zjarrit në njërin prej shtëpive humbën jetën nëna dhe katër fëmijët e saj dhe u shkaktua dëm i konsiderueshëm material. Njësia kundër zjarrit do të vazhdojë rrugëtimin sa profesional po aq edhe në njerëzor në ruajtjen e sigurisë dhe mirëqenies së qytetarëve me të gjitha kapacitetet humane dhe teknike", tha Aliti. Në ndërkohë, kryetarja e Komunës së Tetovës ka nënvizuar se raportet tregojnë se zjarrfikësit kanë arritur në kohë dhe nuk ka patur asnjë pengesë që të intervenohet në kohë. "Dua të shpreh ngushëllimin tim të thellë për familjet të cilat veç shtëpive, në këtë tragjedi humbën edhe më të afërmit e tyre. Të gjithë së bashku ndjejmë dhimbjen e familjes Zylbeari, e cila dje humbi 5 anëtarë, u shua një nënë bashkë me 4 fëmijët e saj. Në emër të institucionit komunë, ju siguroj që kemi bërë dhe do të bëjmë edhe më tutje më të mirën e mundshme për qytetarët tanë. Shtëpitë do ti rindërtojmë, por nuk do i rikthejmë në jetë zemrat që pafundësisht do të kërkojnë njëra-tjetrën. Rastet e tilla, sado që na rikujtojnë se sa jemi të thyeshëm si njerëz, gjithashtu na rikujtojnë arsyet se pse duhet të qëndrojmë bashkë në momente kur dora e kapur për dorë, të jep forcën për tu ngritur lartë dhe për të vazhduar rrugën", deklaroi Arifi.



Kërçova me
stacion
filtrues
modern për
ujëra të zeza
fekale

Kërçovë, 26 janar - Nga fundi i marsit do të lëshohet në përdorim stacion filtrues për ujëra të zeza në Kërçovë, çmimi i të cilit do të jetë 9.3 milionë euro, të siguruara nga programi IPARD 1. Do të ketë kapacitet për 46.000 banorësh. "Stacioni i ri filtrues posedon teknologji austriake, si dhe një numër të madh të stacioneve në vendbanimet në Austri dhe Zvicër dhe vlen për teknologji më bashkëkohore që shfrytëzohet në kontinentin e vjetër", thotë Shasim Osmani, inxhinier kompetent për mbikëqyrje gjatë ndërtimit, i vendosur nga konsorciumi "Ruteks" nga Bullgaria dhe "Garnets" nga Çekia. Ai informoi se stacioni i ri filtrues ndërtohet në dy faza. "Në fazën e parë tërësisht do të ndërtohet stacioni filtrues, si dhe sistemi kolektor në gjatësi prej 4,5 kilometrash, ndërsa shtrihet nëpër rrjedhën e Zajashka Rekës dhe në tetë vende do të ketë lidhës për grumbullim të ujërave të zeza nga qyteti dhe rrethina ose do të ketë kapacitet për 35.000 banorë. Në fazën e dytë do të ndërtohen sisteme kolektore nga komunat e mëparshme Zajaz, Osllomej dhe një pjesë e Drugovës, prej nga ujërat e zeza fekale do të realizohen deri te stacioni filtrues. Me ndërtimin e këtyre tre krahëve tërësisht do të përfundojë ky objekt kapital për komunën tonë", theksoi Osmani. Përkujtoi se pas përfundimit të këtij objekti do të ketë kujdestari 24-orëshe në vetë stacionin, ujërat që do të lëshohen nga stacioni do të kenë 97 për qind pastërti, ndërsa i gjithë sistemi do të punojë me energji elektrike. "Për shkak se stacioni i ri filtrues do të punojë me rrymë, që të përmirësohet fitimi i saj ekonomik, në të mund të ndërtohet edhe sistem kolektor, prej nga vetë objekti në një pjesë do të furnizohet me energji elektrike, ndërsa 20 persona do të inkuadrohen drejtpërdrejt në punën e saj", theksoi Osmani.

"EDEPSËZ DOVLET!"

Nga **Fadil LUSHI**



Të nderuar lexues dhe ju miq të mi pa tarafe! Besoj se edhe kësaj radhe do më ndjeni për trazimin tim karshi "mosrespektimit të standardit të gjuhës së sotme shqipe". E di fare mirë se ju, në parim, keni të drejtë kur më "bëni me faj", sidomos kur unë, ashtu "me a pa hir" e "çekuilibroj" sintaksën e gjuhës shqipe. Unë e di se ju gjithmonë keni të drejtë ndaj "inatit tim homerik", ju keni të drejtë të më qortoni, kur unë e teproj me të folmet krahinore e të tjera fjalë të huazuara që hetohen në opinionet e mia për gazetë. Që të bësh sot një opinion të shëndetshëm, human dhe po aq emancipues për "gjendjen mentale a për gjendjen fiziologjike" të këtij shteti, është paksa e sikletshme. Të shkruash për njerëzit në hall të këtij "dovleti", po nëse do edhe për "kryegjyshin" e tij, duhet të jesh si Millosh Gjergj Nikolla, si Faik Konica dhe si Ismail Kadare.

Meqë unë nuk mund të jem as si i pari, as si i dyti, po as edhe si i treti, atëherë më mbetet të ndërtoj një "shkarravinë ku do të gënjej vetveten", po edhe lexuesit e mi të paanshëm. "Do të qendis" një "shkarravinë" për ca njerëz të cilët kanë shtrirë shalët në kolltukun e rehatshëm të këtij "dovleti", i cili dikur moti, falë një traktati famëkeq, kishte zaptuar me

dredhi një copë vend të "qymezit" të vockël të Gadishullit Ilirik..., një vendi që sot e gjithë ditën e Perëndisë, i mungon tapia, një vend ku ardhacakët mëtojnë t'i dëbojnë banorët autoktonë të këtij oborri, që padrejtësisht mbi vete ka një nëmë shekullore! Dhe, ky "krijim imi pa vlerë" meriton një kësisoj drejtshqiptimi të denigruar dhe kurrëgjë tjetër. Ç'është e vërteta, në këtë "dovlet" jetojnë a mbijetojnë kumarxinj politikë, po edhe daullexhinj ramazani, frymojnë njerëz të cilët detyrohen të qajnë dhe ca të tjerë që zgërdhihen, jetojnë edhe njerëz "shpirtkatranë a shpirtkëllirë"..., njerëz që masturbojnë politikisht, njerëz të cilët "sabah e aksham" bëjnë duan dhe llogaritë e shtetit të sëmure nga "veremi", është një "dovlet", ku jetojnë më shumë bukëshkelës e më pak bukëgatues dhe ca të tjerë toptan hazërxinj dhe dembelë Anadolli..., është një "dovlet", ku fukarai detyrohet të punojë argat te "zengjini edepsëz" për një pagë qesharake!

Është një "dovlet" që më shumë parapëlqen të merret me "anatominë e bythës së pleshtit", sesa me varfërinë e skajshme të miletit që rrezikon "të ngelë pa brekë"..., një milet që ende e ëndërron vendin ku ka "bythë viçi", që fatkeqësisht nuk e gjen dot..., një milet që ka rënë në hall

e që detyrohet derrit t'i thotë dajë!?, një "dovlet" me "kryegjysh", i cili më shumë parapëlqen të hajë "qofte të përgatitura nga koqet e morrit të kuq", sesa të kujdeset për rininë që i është prishur mendja a është hutuar fare nga mungesa e shpresës për një të ardhme të lumtur e të sigurt. Është një "dovlet" që udhëhiqet nga njerëz të cilët ditën kur u sistemuan në kryeqendër, lëre që me vete sollën opingat e stërgjyshërve të tyre, por edhe ca zakone të këqija.

Fillimisht ngatërruan muhabetin politik, ngatërruan diplomacinë e shtetit, harruan miqtë, shokët, fafesisin dhe, më e keqja, harruan prejardhjen e tyre provinciale, harruan dhe prindërit e sëmure dhe të moshuar që i kishin lënë në mëshirën e njerëzve me nijet të mirë..., kishin harruar se në këtë "dovlet të tyre" jetojnë edhe njerëz të cilët kanë histori tjetërfare - ilire. Është një "dovlet" që për "kryegjysh" ka njeriun që mohon dialektikën politike, një "kryegjysh" që nuk nënshkruan asnjë dokument ku zënë vend kërkesat e shqiptarëve, është "kryegjysh" i një "dovleti" i cili në vijimësi errëson a ul me qëllim vlerat e shqiptarëve. Dhe ky "kryegjysh", që hiqet si alamet profesor universitar, në vend që të bëjë punën e presidentit të shtetit, bën punën e zëdhënësit të


Kur nuk do t'ia gjesht dermanin këtij "dovleti dhe kryegjyshit" të tij, do të duhet të ia mbathësh "nga sytë këmbët". Ndryshe nuk bën. Po qe se do të ndash mendjen të ikësh, parashtrohet pyetja, ku do të degdisesh! Të shkosh në shtetin amë, "beter e më beter", edhe atje si te ne, thjesht njësoj. Të marrësh udhë Evrope..., nuk është zgjidhje. Mbase të mbetet vetëm ai shtegu i qëmoçëm – bëj kujdes me kalamajtë e tu!



një partie politike joshqiptare. Dhe kur do hetosh axhamillëkun e "kryegjyshit", atëherë do të detyrohesh ta braktisësh dhe ta sikterisësh këtë "dovlet" toptan, me emër, me identitet të paqenë, me kishë e gjuhë të papranuar, me histori të sajuar, me shtrirje gjeografike të dyshimtë..., një "dovlet biblik" që të bën me faj, që të akuzon se kinse gjithmonë e ke "marrë në qafë", që kinse gjithmonë ia ke futur a ia ke ngulur..., një "dovlet" ku politikanë të papërgjegjshëm dhe të rrjedhur nga fiqiri që, kur urinojnë gjithandej, nuk bëjnë kujdes se mos stërpikin majtas e djathtas, para e mbas. Çuditërisht, këta njerëz asnjëherë nuk mësuan të pshurren si qenushët e pasanikëve, të cilët ambientalistët e ndërgjegjshëm të kryeqytetit i kanë marrë nën përkujdesjen e tyre!

Miku im i nderuar! Kur nuk do t'ia gjesht dermanin këtij "dovleti dhe kryegjyshit" të tij, do të duhet të ia mbathësh "nga sytë këmbët". Ndryshe nuk bën. Po qe se do të ndash mendjen të ikësh, parashtrohet pyetja, ku do të degdisesh! Të shkosh në shtetin amë, "beter e më beter", edhe atje si te ne, thjesht njësoj. Të marrësh udhë Evrope..., nuk është zgjidhje. Mbase të mbetet vetëm ai shtegu i qëmoçëm – bëj kujdes me kalamajtë e tu!


KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



HORIZONTALISHT

- 3. Aktori amerikan, Çarli
- 5. Vit
- 7. Shumicë, tepri (bised.)
- 9. Shprehje matematikore
- 10. Bujtinë
- 12. Vend afër Elbasanit
- 13. Një muaj viti
- 15. Gjendje e vështirë
- 16. E kryejnë namazin
- 18. Lloj druri (shq.)
- 19. Luftëtar me uniformë
- 23. Emri i Palikuqes
- 24. Shtagat, shkopinjtë
- 26. Gadishulli ynë
- 28. Shajak për tirq
- 29. Aktorja maleziane, Zhaklina
- 30. Mjet skijimi
- 31. Këngëtarja serbe, Ljubojeviq
- 33. Festival kulturor kosovar, kushtuar Kadri Zekës dhe vëllezërve Gërvalla
- 41. Qytet në Lituani
- 42. Kërçelli i bimës së misrit
- 43. Koha e mjaftueshme për të bërë diçka pa a ngutur
- 44. Shakaja
- 47. Ministria e Arsimit dhe Shkencës
- 48. Bimë barishtore industriale
- 49. Qytet në Turqi.

FJALËKRYQI KLASIK



VERTIKALISHT

- 1. Nisi, startoj
- 2. Në formë koni
- 3. Mik, jaran
- 4. Një prind
- 5. Kandërr e vogël parazite
- 6. Së bashku
- 8. Qytet në Francë
- 9. Pjellë e pelës
- 11. Futbollisti brazilian, Marcos
- 12. Njësia më e imët e dollarit
- 14. Radiumi
- 15. Radha
- 17. Këngëtarja jonë në foto
- 18. Prift katolik
- 19. Shkopi për të pjekur mbi zjarr
- 21. Gur i lënë jashtë murit, anëcak
- 22. Ujdhesë në Kroaci
- 23. Inicialet e aktorit Istref
- 24. Aktorja shqiptare, Logoreci
- 25. Tantali
- 27. Regjistri zyrtar i të dhënave për sipërfaqet e tokave
- 30. Kitaristi meksikan, Karlos
- 32. Natriumi
- 33. Diplomati ynë, Stilian Noli
- 34. Ulluk prej druri, koritë
- 35. Nënë (krahin.)
- 36. Posedon
- 37. Flori
- 38. Kornizë
- 39. Besim (arab.)
- 40. Tani
- 45. Këngëtarja jonë, baraku
- 46. Njësi kineze e gjatësisë.

Kakuro

e lehtë

		11	16		
	12				
	17			30	
25					4
11			7		
		4			
	17				
		10			

mesatare

			3	30	
		9			
	17	30			
23					3
16			11		
		4			
	19				
	9				

e vështirë

	23	11	4		
16					
				11	
14					23
10			8		
		3			
	15				
		12			

KOHA e lirë për më të rinjtë


FSHEHËSIRA

Figurat e dhëna fshihen diku në fotografi. Ku?




VIZATIMI

Vizatoni duke i bashkuar pikat me radhë!




ZBULIMI

Ngjyrosni fushat me pika që të zbuloni figurën!




LABIRINTI

Cila kafshë do të arrijë para në plazh, macja apo qeni ?



DALLIMET

Cilët janë 6 dallimet në fotografitë e mëposhtme!



Sudoku

i lehtë

			7					
6			5					1
3	7							2 5
				3				
		3	1		7	6		
	5	7		9		1	3	
5	8							9 7
9			4					3
			6					

mesatar

9			2	4				
				6				
5			9	7	6	1		
2	4					9	5	
	1						3	
3	8				4			1
		1	5		6			
		6		4				
			1	3	8			6

i vështirë

		3		4				7
1			9		6			4
			8					9
8	1		9	2	4			
	5		1	7			8	
		8					1	5
	1	4	2					8
							2	



HIT I JULIANA PASHËS: "NUK..." FILM ME T.K.	M	SHTET NË MESHJE (shq.) IKS	Q	HIDHËRIMI I MADH, ZEMËRIMI	RRJEDHË UJI (sh.) FILM ME T.K. (filmi i parë shqiptar)				Ë.N. MEDJE, MENDIM (bised. shq.)
G								FEDERATË (shkurt.) AKTORI AMERIKAN ELIJAH	
AZOT		KËNGËTARI ROBERT (sh Led Zeppelin) FIRMË ITALINE PARFUMËSH				RRETHANAT, GJENDJA		PËLLUM-BESHË KUWAIT NATIONAL ASSEMBLY	
AKTORI AMERIKAN, XHEJMS					I KUQ NË FYTYRË (nga dielli apo turpi) SHKËMBI				
ORGAN QË ÇON USHQIMIN NGA GOJA NË STOMAK						SHTET NË AZI VENDLINDJA E T.K.			VIJË E GJATESISË GJEOGRAFIKE TË TOKËS, MESHITËS
MUAJI I PRANVERËS								BAKËR PËRSHËNET, ALLATURKA E NUSEVE TË REJA	
NJË NDAJ-FOLIE				QYTET NË ZVICËR ELEMENT (shkurt.)				VIJËZA E MESME GJATË SHKRIMIT NË KËTË MOMENT	
ANA OKSA			VENDET NËN SUNDIMIN E EMIRIT KËNGËTARJA TARIFA						Ë.R. SULMI
TEMPO NGJYROS (një sipërfaq)		KËNGËTARJA JONË FARA SHTET (frenq.)			PRIJËSI I KOZAKËVE KLUB FUTB. I SELANIKUT				
L				SHTYLLAT (E SHTEPISE) (vjet.) SHEGË					GJERMANI NJË NUMËR, TRE
KOHA E LIRË	ZËRI MË I LARTË I BURRIT (sh.pashq.) LANTAN						KRYENEÇËSIA AMERICIUM		
LLOJ VETURE RUSE								KRYEQYTETI I GANËS IMPULS	
PERËNDIA E ZJARRIT SIPAS MITOLOGJISË PERSIANE					IDEOLOGU KRYESOR I LËVIZJES KOMBËTARE SHQIPTARE, FRASHËRI				FITORE (ang.)

SUDOKU "Killer" | SUDOKU ">" | KENKEN | ARUKONE | NONOGRAMI MOSBARAZ, TRANSFORM. | GOLF ENIGMATIK | VIZITIMI | MOZAIKU | ZBULIMI | PËR TË RINJTË | KAKURO | FJALËKRYQI KLASIK

SUDOKU

1	2	3	4	5	6	7	8	9
10	11	12	13	14	15	16	17	18
19	20	21	22	23	24	25	26	27
28	29	30	31	32	33	34	35	36
37	38	39	40	41	42	43	44	45
46	47	48	49	50	51	52	53	54
55	56	57	58	59	60	61	62	63
64	65	66	67	68	69	70	71	72
73	74	75	76	77	78	79	80	81
82	83	84	85	86	87	88	89	90
91	92	93	94	95	96	97	98	99
100	101	102	103	104	105	106	107	108
109	110	111	112	113	114	115	116	117
118	119	120	121	122	123	124	125	126
127	128	129	130	131	132	133	134	135
136	137	138	139	140	141	142	143	144
145	146	147	148	149	150	151	152	153
154	155	156	157	158	159	160	161	162
163	164	165	166	167	168	169	170	171
172	173	174	175	176	177	178	179	180
181	182	183	184	185	186	187	188	189
190	191	192	193	194	195	196	197	198
199	200	201	202	203	204	205	206	207
208	209	210	211	212	213	214	215	216
217	218	219	220	221	222	223	224	225
226	227	228	229	230	231	232	233	234
235	236	237	238	239	240	241	242	243
244	245	246	247	248	249	250	251	252
253	254	255	256	257	258	259	260	261
262	263	264	265	266	267	268	269	270
271	272	273	274	275	276	277	278	279
280	281	282	283	284	285	286	287	288
289	290	291	292	293	294	295	296	297
298	299	300	301	302	303	304	305	306
307	308	309	310	311	312	313	314	315
316	317	318	319	320	321	322	323	324
325	326	327	328	329	330	331	332	333
334	335	336	337	338	339	340	341	342
343	344	345	346	347	348	349	350	351
352	353	354	355	356	357	358	359	360
361	362	363	364	365	366	367	368	369
370	371	372	373	374	375	376	377	378
379	380	381	382	383	384	385	386	387
388	389	390	391	392	393	394	395	396
397	398	399	400	401	402	403	404	405
406	407	408	409	410	411	412	413	414
415	416	417	418	419	420	421	422	423
424	425	426	427	428	429	430	431	432
433	434	435	436	437	438	439	440	441
442	443	444	445	446	447	448	449	450
451	452	453	454	455	456	457	458	459
460	461	462	463	464	465	466	467	468
469	470	471	472	473	474	475	476	477
478	479	480	481	482	483	484	485	486
487	488	489	490	491	492	493	494	495
496	497	498	499	500	501	502	503	504
505	506	507	508	509	510	511	512	513
514	515	516	517	518	519	520	521	522
523	524	525	526	527	528	529	530	531
532	533	534	535	536	537	538	539	540
541	542	543	544	545	546	547	548	549
550	551	552	553	554	555	556	557	558
559	560	561	562	563	564	565	566	567
568	569	570	571	572	573	574	575	576
577	578	579	580	581	582	583	584	585
586	587	588	589	590	591	592	593	594
595	596	597	598	599	600	601	602	603
604	605	606	607	608	609	610	611	612
613	614	615	616	617	618	619	620	621
622	623	624	625	626	627	628	629	630
631	632	633	634	635	636	637	638	639
640	641	642	643	644	645	646	647	648
649	650	651	652	653	654	655	656	657
658	659	660	661	662	663	664	665	666
667	668	669	670	671	672	673	674	675
676	677	678	679	680	681	682	683	684
685	686	687	688	689	690	691	692	693
694	695	696	697	698	699	700	701	702
703	704	705	706	707	708	709	710	711
712	713	714	715	716	717	718	719	720
721	722	723	724	725	726	727	728	729
730	731	732	733	734	735	736	737	738
739	740	741	742	743	744	745	746	747
748	749	750	751	752	753	754	755	756
757	758	759	760	761	762	763	764	765
766	767	768	769	770	771	772	773	774
775	776	777	778	779	780	781	782	783
784	785	786	787	788	789	790	791	792
793	794	795	796	797	798	799	800	801
802	803	804	805	806	807	808	809	810
811	812	813	814	815	816	817	818	819
820	821	822	823	824	825	826	827	828
829	830	831	832	833	834	835	836	837
838	839	840	841	842	843	844	845	846
847	848	849	850	851	852	853	854	855
856	857	858	859	860	861	862	863	864
865	866	867	868	869	870	871	872	873
874	875	876	877	878	879	880	881	882
883	884	885	886	887	888	889	890	891
892	893	894	895	896	897	898	899	900
901	902	903	904	905	906	907	908	909
910	911	912	913	914	915	916	917	918
919	920	921	922	923	924	925	926	927
928	929	930	931	932	933	934	935	936
937	938	939	940	941	942	943	944	945
946	947	948	949	950	951	952	953	954
955	956	957	958	959	960	961	962	963
964	965	966	967	968	969	970	971	972
973	974	975	976	977	978	979	980	981
982	983	984	985	986	987	988	989	990
991	992	993	994	995	996	997	998	999
1000								

KRIFTOGRAMI

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24	25	26	27	28	29	30	31	32	33	34	35	36	37	38	39	40	41	42	43	44	45	46	47	48	49	50	51	52	53	54	55	56	57	58	59	60	61
---	---	---	---	---	---	---	---	---	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----



Zhong Zhong lindi tetë javë më parë dhe është emëruar pas fjalës komb në kinezçe. Hua Hua lindi gjashtë javë më parë.

Studiuesit thonë se majmunët po ushqehen me shishe dhe aktualisht po rriten normalisht. Ata presin që më shumë klone majmunësh të lindin gjatë muajve të ardhshëm



KLONOHEHEN DY MAJMJUNËT E PARË NË KINË!

Dy majmunë janë klonuar në Kinë duke përdorur teknikën që prodhoi delen Dolly. Zhong Zhong dhe Hua Hua lindën disa javë më parë në një laborator në Kinë, transmeton Shqip, raportimet. Shkencëtarët thonë se popullatat e majmunëve që janë gjenetiksht identikë do të jenë të dobishëm për hulumtimin e sëmundjeve njerëzore. Por kritikët thonë se puna ngre shqetësime etike duke afruar botën me klonimin njerë-

zor. Qiang Sun i Akademisë kineze të Shkencave tha se majmunët e klonuar do të jenë të dobishëm si një model për studimin e sëmundjeve me një bazë gjenetike, duke përfshirë disa kancere, çrregullime metabolike dhe imune. "Ka shumë pyetje në lidhje me biologjinë e primatit që mund të studiohet duke pasur këtë model shitesë", tha ai.

Zhong Zhong lindi tetë javë më parë dhe është emëruar pas fjalës

komb në kinezçe. Hua Hua lindi gjashtë javë më parë. Studiuesit thonë se majmunët po ushqehen me shishe dhe aktualisht po rriten normalisht. Ata presin që më shumë klone majmunësh të lindin gjatë muajve të ardhshëm. Prof Darren Griffin i Universitetit të Kent thotë se qasja mund të jetë e dobishme në kuptimin e sëmundjeve njerëzore, por ka ngritur shqetësime etike.

"Një konsideratë e kujdesshme duhet t'i jepet kuadrit etik nën të cilin eksperimente të tilla mund dhe duhet të funksionojnë", tha ai. Në studimin e botuar në revistën Cell, rezultojnë se shkencëtarët përdorën ADN-në nga qelizat e indit lidhës të fetusit. Pasi ADN-ja iu

transferua vezëve të dhuruara, ri-programimi gjenetik u përdor për të ndryshuar gjenet që ndryshe do të kishin ndaluar zhvillimin e embrionit. Zhong Zhong dhe Hua Hua ishin rezultat i 79 përpjekjeve. Dy majmunë të tjerë fillimisht u klonuan nga një lloj tjetër i qelizave të rritura, por nuk arritën të mbijetonin. Dr Sun tha: "Kemi provuar disa metoda të ndryshme, por vetëm një ka funksionuar. Ka pasur shumë dështime përpara se të gjejmë një mënyrë për të klonuar me sukses një majmun". Shkencëtarët thonë se ata kanë ndjekur udhëzime të rrepta ndërkombëtare për kërkimin e kafshëve, të përcaktuara nga Institutet Kombëtare të Shëndetit në SHBA.

Kanceri i gjirit, kjo shenjë te meshkujt tregon sëmundjen vdekjeprurëse

Kanceri i gjirit zakonisht është i pranishëm te gratë, por burrat mund të preken nga kjo sëmundje e rrezikshme. Simptomat te meshkujt janë të ngjashme me ato që gjenden te gratë - gungat e vogla në sqetull mund të jenë shenjë treguese. Ndërsa një në tetë gra do të diagnostikohet me kancer të gjirit gjatë jetës së tyre, një në 870 burra do të preken nga sëmundja. Zakonisht ndodh te meshkujt mbi moshën 60 vjeç, por shumë herë pas here mund të preken meshkujt e rinj. Meshkujt e diagnostikuar me kancer gjiri në një fazë të hershme kanë një shans të mirë për një kurë, por ende shumë burra vonojnë të vizitojnë mjekun nëse vërejnë një nga shenjat ose simptomat e zakonshme. Sipas NHS, simptomat e kancerit të gjirit në meshkuj përfshijnë: Një gungë në gjiri - kjo zakonisht është e vështirë, pa dhimbje dhe nuk lëvizë brenda gjirit. Ju duhet të vizitoni mjekun menjëherë nëse vëreni se keni një simptomë të tillë.

Varësia nga testet e shtatzënisë

Ta kuptoni se keni mbetur shtatzënë është një nga momentet më emocionuese në jetë, e në veçanti kur për një kohë të gjatë keni pritur të keni një bebe. Prandaj, nuk është befasi që shumë nëna në pritje bëjnë më shumë se një test të shtatzënisë për t'i konfirmuar lajmet e mira. Sipas hulumtimeve të reja nga ueb sajt i prindërve 'ChannelMum', gratë shtatzëna në Mbretërinë e Bashkuar me shumë gjasë janë duke u bërë të varura nga testet e shtatzënisë përgjatë javëve të para të shtatzënisë së tyre. Duke e quajtur këtë fenomen si 'varësia nga testi i shtatzënisë', sajt thotë se 62 për qind e nënave në pritje pranojnë se herë pas here bëjnë teste të tilla edhe pasi i kanë pranuar rezultatet pozitive - ku një në 12 gra e bëjnë këtë deri të vjen koha e skanimit 12-javor. Por, cila është arsyeja për këtë? Gratë duan ta sigurojnë vetveten se çdo gjë është duke shkuar në rregull me shtatzëninë e tyre gjatë javëve të hershme kritike. Dhe, përderisa nuk ka asgjë të gabuar rreth kësaj, kostoja e testeve të përsëritura mund të jetë pak e lartë. Ekspertët sugjerojnë të mos bëheni e varur nga këto teste, sepse janë të shtrenjta dhe është i panevojshëm testimi i vazhdueshëm.

Edhe vetëm një cigare në ditë, vë në rrezik zemrën



Edhe vetëm një cigare në ditë është e mjaftueshme për ta vënë zemrën në rrezik. Shanset për të pasur sëmundje koronare të zemrës dhe goditje, kanë më shumë gjasa sesa pritjet (rreth gjysma e rrezikut të pirjes së duhanit

20 në ditë). Kjo është ajo që del nga një studim i Institutit të Kancerit UCL të Kolegjit Universitar të Londrës, botuar në BMJ. Studiuesit analizuan 55 raporte, rezultat i 141 hulumtimeve midis viteve 1946 dhe 2015 dhe vlerësuan rrezikun

relativ të pirjes së duhanit, të një cigareje, pesë ose njëzet në ditë. Ata zbuluan se meshkujt që pinë një cigare në ditë, kishin rreth 48% më shumë rrezik për zhvillimin e sëmundjeve koronare të zemrës dhe 25% më shumë gjasa të kenë një goditje në tru, se sa ata që kurrë nuk kishin pirë duhan. Për femrat, ajo ishte edhe më e lartë: 57% për sëmundjet e zemrës dhe 31% për goditje në tru. Për më tepër, njerëzit që pinë një cigare në ditë, kishin 53% të rrezikut të sëmundjeve koronare të zemrës tek ata që pinë 20 dhe 64% të rrezikut të iktusit. Nga ana tjetër, gratë që pinë një cigare në ditë, kishin 38% të

rrezikut të sëmundjeve koronare të zemrës dhe 36% të rrezikut të goditjes së atyre që pinë 20. "Ne kemi treguar se një përqindje e madhe e rrezikut të sëmundjeve koronare të zemrës dhe goditjes vjen nga pirja e duhanit me vetëm disa cigare në ditë," thonë autorët. "Kjo ndoshta është një surprizë për shumë njerëz, por ka edhe mekanizma biologjikë që ndihmojnë në shpjegimin e këtij rreziku të papritur të lartë që lidhet me një nivel të ulët të pirjes së duhanit". Në një editorial të lidhur, Kenneth Johnson, i Universitetit të Otavës, thotë se "vetëm ndërprerja e plotë është mbrojtëse".

BE PËRCAKTON STRATEGJINË E PAJTIMIT

2019-A, AFATI I FUNDIT I SERBISË PËR KOSOVËN

Në dokument figuron edhe ky formulim: "Serbia dhe Kosova duhet, më së largu deri në këtë fazë të realizojnë normalizimin gjithëpërfshirës të marrëdhënieve, që do të duhej të hapte rrugë për përparimin thelbësor të Kosovës në rrugën e integritimit evropian", transmeton Koha.net.



Normalizimi gjithëpërfshirës i marrëdhënieve midis Serbisë e Kosovës, në formë të një marrëveshjeje detyruese, për Bashkimin Evropian përbën çështje urgjente. Kështu, sipas mediave serbe, shkruan në variantin punues të Strategjisë së BE-së për zgjerim. Sipas gazetës "Večernje Novosti", që pohon se e ka pasur në dorë këtë dokument, i cili edhe zyrtarisht do të duhej të prezantohet në shkurt, marrëveshja midis Beogradit e Prishtinës ka rëndësi thelbësore për perspektivën evropiane si për Kosovën, ashtu edhe për Serbinë dhe rajonin më gjerë. Theksohet se përfaqësuesja e lartë e BE-së do të intensifikojë angazhimin e saj në lehtësimin e negociatave midis Prishtinës e Beogradit me qëllim të arritjes së normalizimit të marrëdhënieve në formën e marrëveshjes juridikisht detyruese. Sipas Strategjisë, më së largu deri më 2019, ndër të tjera, Beogradi duhet të përmbushë kriteret kalimtare në kuadër të Kreut 35, që kanë të bëjnë me Kosovën. Në dokument figu-

ron edhe ky formulim: "Serbia dhe Kosova duhet, më së largu deri në këtë fazë të realizojnë normalizimin gjithëpërfshirës të marrëdhënieve, që do të duhej të hapte rrugë për përparimin thelbësor të Kosovës në rrugën e integritimit evropian", transmeton Koha.net. E gjithë kjo do të thotë se brenda më pak se dy vjetësh Beogradi e Prishtina do të duhej të mbyllnin të gjitha temat kontestuese, që tingëllon shumë ambicioze, duke pasur parasysh ritmin e ecjes me shpejtësi breshke të dialogut të deritashëm. "Novosti" citon bashkëbiseduesit rreth kësaj çështjeje, sipas të cilëve nuk është e pamundur që të arrihet marrëveshja midis Beogradit e Prishtinës deri në fund të vitit të ardhshëm, por me "asistimin" e shteteve me ndikim. "Ngritja e negociatave në nivel presidentësh bën të mundur që çdo gjë të përfundojë brenda një viti,

porse kusht mbi kushtet do të jetë që Prishtina të përmbushë të gjitha ato për të cilat është obliguar, ndërsa në plan të parë është të themelojë Bashkësinë e Komunave Serbe. Amerika do të citojë në dinamikën e bisedimeve, por nuk pres që të përfshihet drejtpërdrejt në dialog, ashtu si edhe Rusia, ndërsa pres që dialogu do të përshpejtohet pas formimit të Qeverisë së Gjermanisë", ka thënë profesori i Fakultetit të Shkencave Politike, Dragan Gjukanović, e sipas të cilit normalizimi mund të arrihet deri në fund të këtij viti ose më së largu në fillim të vitit 2019. Ambasadori i dikurshëm serb, Millovan Bozhinović shfaq përshtypjen se pushteti po e përgatit opinionin psikikisht për vendime të mëdha. "Ato askush nuk dëshiron t'i marrë brenda mandatit të vet, por kjo njëherë duhet të ndodhë. Ende jemi larg nga një fund i qartë, por a do të jenë

të mjaftueshme dy vjet nuk do të varet aq nga pala serbe e shqiptare, por nga fuqitë e mëdha. Nëse Prishtina "stimulohet" për të përmbushur detyrimet deri në fund të vitit 2019 do të mund të arrihet një marrëveshje", konsideron Bozhinović. Kriteret kalimtare që duhet t'i përmbushë Serbia në lidhje me Kosovën janë pasqyruar në pozicionin e përbashkët të BE për kapitullin 35 nga nëntori i vitit 2015. Aty thuhet se ato janë zbatimi i marrëveshjes së parë nga prilli i vitit 2013, që vetëkupton BKS-në (Asociacionin e Komunave Serbe), marrëveshjet për policinë, gjyqësorin, si dhe marrëveshjet që lidhen me doganën, lirinë e lëvizjes, urën në Mitrovicë, njohjen e diplomave dhe pjesëmarrjen e Kosovës në nismat rajonale. Theksohet, po ashtu, se ky grup i parë i kriterëve kalimtare "do të azhurnohen sipas nevojës", transmeton Koha.net.

Mbi 3100 biznese të regjistruara në veri

Në katër komunat veriore të Kosovës, Mitrovicë e Veriut, Zvečan, Leposaviq dhe Zubin Potok, janë të regjistruara 3180 subjekte ekonomike (biznese), veprimtaria kryesore e të cilave është tregtia me shumicë dhe me pakicë, bujqësia, industria e përpunuar dhe ndërtimtaria, shkruan sot Gazeta 'Zëri'. Sipas një studimi të Institutit për Zhvillimin Ekonomik Territorial – InTER në veri të Mitrovicës, numri i bizneseve të regjistruara në komunat veriore të Kosovës është rritur pas marrëveshjeve të arritura në Bruksel, veçanërisht në vitin 2015. Studimi ka treguar se veprimtaritë kryesore të bizneseve në veri janë: tregtia, bujqësia, ndërtimtaria dhe industria e përpunuar. Duke paraqitur rezultatet e hulumtimit në një tryezë të mbajtur në veri të Mitrovicës, Jovana Jakovleviq, hulumtuese e InTER, ka thënë se kjo strukturë e veprimtarive ndryshon në Mitrovicën Veriore, ku bujqësia nuk është edhe aq shumë e përfaqësuar, por që zëvendësohet me inovacione shkencore teknike për shkak të prezencës së Universitetit serb në Mitrovicën veriore. "Kur bëhet fjalë për trendin e regjistrimit të subjekteve ekonomike në veri të Kosovës, duke shikuar periudhën nga viti 2000, kur ka filluar regjistrimi i afaristëve në Agjencinë për Regjistrimin e Subjekteve Ekonomike të Kosovës e deri në fund të vitit 2017 numri i subjekteve ekonomike të regjistruara me sistemin kosovar është rritur dukshëm pas marrëveshjeve të arritura në Bruksel, më së shumti janë regjistruar në vitin 2015", ka thënë Jakovleviq. (zëri)

Shpërfillje e mospajtme ndërmjet liderëve të Kosovës dhe ambasadorëve

Mospërfillje e ndërsjellë dhe retorikë e ashpër politike po karakterizon raportet ndërmjet liderëve institucionalë të Kosovës dhe ambasadorëve të vendeve të Kuintit, që përfaqësojnë pesë Qeveritë më të fuqishme të Perëndimit. Mospajtimet ndërlidhen me dy nga çështjet më të rëndësishme aktuale në skenën politike të Kosovës, siç është ratifikimi i Marrëveshjes së demarkacionit të kufirit me Malin e Zi dhe nisma për shfuqizimin e Ligjit për Gjykatën Speciale për krime lufte. Analistët e çështjeve politike thonë se raporte të tilla të lidhshimit të Kosovës me përfaqësuesit e vendeve aleate, po vërehen për herë të parë në këto dekadat e



fundit. Rasti më i freskët që dëshmon dallimet në pozicionet rreth proceseve aktuale, ishte deklarata e kryeministri të Kosovës, Ramush Haradinaj, të mërkurën, kur tha se Qeveria e tij nuk u jep llogari

ambasadorëve. "Qeveria e vendit llogari i jep Parlamentit. Parlamenti na ka zgjedhë. Ambasadorëve u japim llogari në marrëdhëniet diplomatike, në marrëdhëniet me shtetet. Ne nuk

i kemi punëdhënës ata, ne punëdhënës i kemi deputetët", ka thënë Haradinaj. Paraprakisht, edhe presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, kishte adresuar një mori kritikash, sidomos ndaj Bashkimit

Evropian, për faktin se po vazhdon ta mbajë Kosovën në izolim, pa liberalizim të vizave. Ndërkaq, në lidhje me Gjykatën Speciale, Thaçi kishte theksuar se përfaqësuesit ndërkombëtarë i kishin premtuar Kosovës liberalizim të vizave dhe perspektivë evropiane, në këmbim të themelimit të kësaj gjykate. Deklaratat e lidhshimit në Kosovë, i kanë pasuar thirrjet e vazhdueshme të ambasadorëve të vendeve të Kuintit, të cilët kanë kërkuar që të hiqet dorë nga nisma për shfuqizimin e Ligjit për Gjykatën Speciale, duke theksuar se në të kundërtën, politikanët që e aprovojnë atë nismë do të përballen me pasojat e rënda.

SHTETI QË HETON HETUESIT!

Kush ka dijeni për afera korrupsioni në radhët e anëtarëve të qeverisë në Maltë është në rrezik. Pas vrasjes së gazetares Daphne Caruana Galizia, tani jeton me frikë një ish-hetues

Makinën ai e parkon gjithmonë aty ku ka kamera survejimi. Pas vrasjes së gazetares Daphne Caruana Galizia me një autobombë, ish-hetuesi Jonathan Ferris ka frikë sa herë hipën në makinë. Gazetarja kishte denoncuar në blogun e saj korrupsionin në Qeveri. Sipas të dhënave të saj, ministri Konrad Mizzi dhe shefi i kabinetit Keith Schembri kanë themeluar firma dhe kompani në parajsat e taksave. Këtë e dëshmojnë edhe Panamapapers. Në llogaritë e politikanëve janë bërë me sa duket pagesa të dyshimta, sipas shumë gjasash ryshfete. Akuza më shpërthyes e gazetares ishte se gruaja e kreut të qeverisë, Michelle Muscat, ka themeluar një kompani off shore me emrin "Egrant" dhe se ka marrë një milion euro në një llogari të fshehtë. Pesë muaj pas botimit të këtyre të dhënave gazetarja investigative gjeti vdekjen. Atë e vranë. Sfondi i krimi është ende i paqartë. Mos vallë sepse dinte shumë?

Tani frikë se mund të pësojë të njëjtin fat ka Jonathan Ferris. Në Maltë ai njihet si hetues i mprehtë. Deri para disa kohësh ai udhëhoqte Njësinë kundër Pastrimit të Parave dhe që i ngarkuar me hetimet e akuzat ndaj zonjës së parë, Michelle Muscat. "Në Maltë ka arrihur puna aty sa kemi dy lloj ligjesh: një për perënditë dhe tjetra për njerëzit e thjeshtë", thotë Jonathan Ferris. Ai është i bindur se korrupsioni në Maltë është shumë më i



thellë. "Pasi u shpjegova shefave të mi se si do t'i zhvilloja me grupin tim hetimet për rastin Michelle Muscat, të nesërmen në mesditë më komunikuan pushimin nga puna". Argumenti i punëdhënësit ishte se unë kinse nuk plotësoj kërkesat, kurse unë mendoj se u bëra i rrezikshëm për ta, thotë Ferris.

LAJMETË RREME?

Vetë kryeministri Joseph Muscat i quan akuzat si lajme të rreme. Në vend që të sqarojë çështjen ai organizoi zgjedhje të reja dhe i fitoi ato, për shkak se ekonomia polulëzon dhe kjo është e mjaftueshme për shumë malteze. Dhe megjithëse dyshimet për korrupsion të rëndë vazhdojnë, dy miqtë e tij janë edhe gjysmë viti më pas

ende në detyrë. Pyetjes se pse nuk i pezullon ata, ai i përgjigjet: "Ju lutem ju bëni detyrat tuaja, dhe mos u mbështetni në informacione të rreme nga njerëzit me synime të këqija! Unë kam thënë gjithmonë se nëse ka ndonjë dëshmi ose madje edhe treguesin më të vogël se akuzat kundër meje janë të vërteta, atëherë do të jap menjëherë dorëheqjen. Por nëse del se të gjitha këto dokumente dhe informacione janë të gabuara, atëherë do t'i këshilloja ata që më akuzojnë që të japin dorëheqjen".

ASGJË NUK NDODH

Gazetarja Daphne Caruana Galizia nuk mund të japë më dorëheqjen, dhe as hetuesi Jonathan Ferris, sepse atë e kanë pushuar nga puna. Edhe policia e pranon vetë se

nuk po heton. Ndërkohë që njësia kundër pastrimit të parave i ka përmbledhur provat e rënda në raporte dhe ia ka përcjellë ato policisë për të siguruar provat, dhe ngrirë llogaritë bankare. "Asgjë nuk po ndodh. Vetë shefi i policisë ka thënë se nuk do të ketë hetime ndaj politikanëve. Por si mund të zbardhet një krim nëse nuk heton? Qëndrime të tilla nuk ka pasur kurrë më parë", thotë Ferris. Të gjitha shpresat e tij tani varen tek BE-ja: ajo duhet të ushtrojë presion mbi autoritetet e vendit të tij. Dhe kjo është arsyeja pse disa eurodeputetë erdhën posaçërisht nga Brukseli për t'u informuar për çështjen e pastrimit të parave dhe nëse qytetarët e Maltës janë të barabartë para ligjit. Si anëtare e BE-së, Malta duhet ta garantojë barazinë para ligjit. Por dyshimet janë të mëdha. "Unë jam i shqetësuar për gjendjen e sundimit të ligjit. Ne morëm informacione të rëndësishme nga Jonathan Ferris, që është i shqetësuar për sigurinë e tij dhe sidomos për fëmijët dhe të shoqen. Ne kërkuam që ai të vihet nën mbrojtje policore ditë e natë, atij i kanë dhënë tani mbrojtje policore. Me sa duket kush flet këtu haptazi për të tilla gjëra, është padyshim në rrezik". - thotë eurodeputeti Sven Giegold.

PADI NDAJ SHTETIT

Ferris ka ngritur padi kundër shkarkimit të tij. Në këtë proces ai dëshiron që më në fund t'i tregojë të gjitha. Ai thotë se këtë ia ka borxh gazetares së vranë dhe të gjithë maltezëve të ndershëm. Dhe për rastin se i ndodh diçka, i ka marrë masa paraprake. "Shënimet e mia dhe gjithçka që di i kam futur në gjashtë zarfa dhe ua kam shpërndarë njerëzve të ndryshëm. Nëse mua më ndodh diçka, gjithçka do të dalë në shesh. Dhe të gjithë do ta mësojnë të vërtetën. Kjo do të jetë hakmarrja ime".



Trump nuk ndalet: Palestinezët janë mosmirënjohës

Presidenti i SHBA-ve, Donald Trump është pyetur në Davos, nëse bisedimet e paqes mes Izraelit dhe Palestinës do të rifillojnë. Në përgjigjen e dhënë ai nuk ka hezituar të fajësojë palestinezët. Trump tha se palestinezët kishin treguar "mosmirënjohje" ndaj SHBA-ve pas vendimit të tij të diskutueshëm për të njohur Jerusalemin si kryeqytetin e Izraelit. "Respekti duhet t'i tregohet SHBA-ve ose nuk do të shkojmë më tutje", u tha ai gazetareve në Davos. Palestinezët thonë se SHBA nuk mund të konsiderohet më as një ndërmjetës neutral për bisedimet. Presidenti Mahmoud Abbas e ka quajtur deklaratën e Trump për Jerusalemin në dhjetor "shuplakën e shekullit". Megjithatë, duke u ulur pranë Kryeministrit izraelit Benjamin Netanjahu në Forumin Ekonomik Botëror, Trump tha: "Izraeli gjithmonë ka mbështetur Shtetet e Bashkuara, kështu që ajo që bëra me Jerusalemin ishte nderi im".

Britania mund të ndërmarrë masa kundër kriptovalutave

Kryeministria e Britanisë, Theresa May, paralajmëroi se vendi mund të ndërmarrë masa ndaj kriptovalutave. "Mund të nevojitet ndërmarrje masash kundër formave të përdorimit dhe përdorimit të tyre nga ana e kriminelëve", tha May në një reportazh për Bloomberg TV, duke theksuar se do t'i shikojnë në mënyrë serioze fushat si ajo e kriptovalutave. Ndërkaq, duke folur në lidhje me rritjen e vlerës së kriptovalutës Bitcoin, May tha se kjo është një çështje të cilën duhet ta shikojnë. Pohohet se paratë digjitale prej kohësh përdoren në aktivitete ilegale, përfshirë trafikimin ndërkombëtar të drogës, për arsye se, siç thuhet, vështirësitë në ndjekjen e transaksioneve ka lehtësuar kryerjen e këtyre aktiviteteve.

175 vite burg për mjekun që ngacmoi seksualisht 160 vajza

Ish-mjeku i ekipit amerikan të gjimnastikës, Larry Nassar është dënuar me 175 vite burg pas dëshmisë së afro 160 prej viktimave të tij. Gjykatësi e hodhi poshtë deklaratën e Nassarit si të pasinqertë kur u përpoq të kërkonte falje në gjykatë. Nassar, 54 vjeç, u deklarua fajtor për akuzat të shumta të sulmit seksual kundër grave dhe vajzave të reja, duke përfshirë edhe olimpistët.

Gjyqtarja Rosemarie Aqualina i tha Nassarit gjatë dënimit se do të "mbetet në errësirë pjesën tjetër



të jetës së tij". "Aq sa ishte nderi dhe privilegji im për të dëgjuar të mbijetuarit, ishte nderi im dhe pri-

vilegji t'ju dënoju juve. Sepse, zotëri, nuk e meritoni të dilni jashtë burgut", tha ajo. Ajo shtoi: "unë

sapo e kam nënshkruar urdhrin tuaj të vdekjes". Ai deri më tani ishte dënuar me 60 vjet për posedim të video pornografike të fëmijëve, para se të deklaronte fajin për 10 akuzat për sjellje seksuale kriminale. Pas shtatë ditëve të dëshmisë emocionale nga viktimat e Nassarit, atij iu dha një mundësi për t'u drejtuar gjykatës. "Unë ndihem i palëkundur në krahasim me dhimbjen, traumën dhe shkatërrimin emocional që të gjithë ju ndjeni", tha ai në sallën e tejmshur.

“TALIA E FLAKËS”, SHFAQET MONODRAMA “PORTRETI I PAKRYER”

Publiku të enjten në mbrëmje e ka mbushur sallën e Teatrit të Qyteti të Gjilanit, ku në skenë është vënë monodrama “Portreti i Pakryer”, me autor Besim Rexhaj, me regji të regjisores Elmaze Nura, e me aktrimin e Aurita Agushit. Këtë shfaqje, në Festivalin e Dramës Shqipe “Talia e Flakës”, e sollli Teatri Dodona, ndërsa në ekipin realizues ishin edhe Memli Kelmendi - muzika, Agnes Nokshiqi - koreografia, Majlinda Kelmendi skenografia e Samka Ferri - kostumet, derisa për ndriçim

ishte përkujdesur Skënder Latifi. Kjo monodramë zhvillohet në vitet 90-ta të shekullit të kaluar, ku aktorja Aurita Agushi na sjellë personazhin e një gruaje, fatin e saj, përpëlitjen me vetveten, por edhe me të tjerët, për të shpërthyer dufin e revoltës që ka përbrenda vetes. Ajo ishte viktimë e kurtheve të jetës dhe e kurtheve të familjes së saj, të babait, i cili në vitet e 90'ta ishte pjesë e sistemin politik. Poashtu, ajo me vite përpëlitet ta ruaj dashurinë për njeriun e jetës, një i bur-

gosur politik, por që letra e lamtumirës nga ai, e sjellë atë në një situatë kritike, në një situatë psikologjike të rëndë. Megjithatë ajo përpëlitet t'i ngjallë vetës shpresë, duke u përpjekur që të jetë vetvetja, duke u përbalë me konfliktet e brendshme e të jashtme, me vetveten e me të tjerët, duke luftuar me zërat brenda vetes që e pushtojnë..., por që në fund tretet brenda errësirës së skenës, derisa në sfond alarmi nxjerrë edhe tragjikën e kësaj shfaqjeje



Opera “Carmen” rikthehet në skenë pas 16 vitesh

Premiera e parë që hap sezonin operistik 2018 për Teatrin e Operës dhe Baletit në Tiranë është opera “Carmen” me regji nga Gëzim Myshketa. Një nga produksionet më të mëdha të teatrit, në skenën e Pallatit të Kongreseve do të jenë 170 artistë mes tyre këngëtarë lirik, balerinë dhe aktorë të njohur. “Carmen” rikthen në skenë shqiptare pas 16 vitesh dhe balerinën e njohur Ambeta Toromani, pjesë e shfaqjes së baletit dhe aktorja Tinka Kutri, të cilën regjisori Myshketa e sjell në rolin e nënës së Don Jose. Kryevepra e Georges Bizet këtë herë bën bashkë artistë shqiptarë dhe të huaj. Në rolin kryesor rikthehet në skenë mezzosopranoja Vike-na Kamenica, pjesë e kastit është dhe Eva Golemi, Armando Likaj, etj, por edhe artistë të huaj si tenori Giancarlo Monslave, balerini Alessandro Macariom. Vepra do të drejtohet nga dirigjenti Ricardo Casero dhe numrat e baletit janë përgatitur nga koreografi Cheorghje Iancu. Pas 16 vitesh në skenën shqiptare balerina e njohur Ambeta Toromani tregon se pjesëmarrja në këtë produksion është mjaft emocionuese edhe pse ajo shprehet se është pjesë plotësuese e “Carmen”.



Apartamentet e Kadaresë e Agollit, shtëpi muze?

Bashkia e Tiranës do të blejë dy apartamentet ku kanë jetuar shkrimtarët e njohur Ismail Kadare dhe Dritëro Agolli për ti kthyer në shtëpi muze.

Projektvendimi është përgatitur nga administrata e Bashkisë dhe pritet të kalojë për miratim në mbledhjen e parashikuar për në 31 Janar.

“Shtëpitë e tyre janë në fakt dy apartamente respektivisht në katin e tretë dhe të katërt të një pallati në Rrugën e Dibrës. Ky pallat u ndërtua pranë mapos në Rrugën e Dibrës nga arkitekti Maks Velo në vitin 1972. Ndërtesa u vu në qendër të akuzave të kohës dhe regjimit të atëhershëm duke u quajtur moderniste dhe kubiste”, thuhet në relacionin e projektvendimit.

Sakaq, kthimi në muze i apartamenteve është një ide joshëse për familjet e shkrimtarëve, po aq sa e vështirë. Është shumë e vështirë për ta, të ndahen me kujtimet e një jetë të tërë, mes atyre mureve.

E pyetur nga “GSh”, Sadije Agolli, bashkëshortja e Dritëro Agollit, tha në linjë telefonike se “e kam shumë të vështirë të ndahem prej shtëpisë. Nuk e di a do mundem. Kam një jetë këtu dhe nuk e nëse kam fuqi të iki prej saj”.



Petrit Çeku në festivalit e muzikës klasike “:alpenarte”

“:alpenarte-Festival” në Schwarzenberg (Austri) këtë vit e ka sezonin e vet të dytë ndërsa koncepti mbetet i njëjti. Bëhet fjalë për një festival “më ndryshe”, ose alternativ, të muzikës klasike. Por të rinj janë drejtuesit e tij. Udhëheqës artistik është klarinetisti 31 vjeçar Sebastian Manz. Ndërsa intendant (“intendant in Residence”) i festivalit, gjegjësisht i katër koncerteve që do të mbahen në muajin prill, është Petrit Çeku, shkruan vol.at.

Kitaristi nga Kosova, pritet të vendosë fokusin e festivalit në instrumentin e tij. Funkcioni që i është besuar atij ka të bëjë me sezonin pranveror të

festivalit (prill), ndërsa sezoni vjeshtor mbahet në vjeshtë, transmeton albinfo.ch. “Histoire du Tango” do të jetë si një pe i kuq që përshkon koncertin e hapjes. Në mbrëmjet e radhës në program janë krijime të Mocartit e të Bethovenit ashtu sikurse edhe vallet popullore rumune të Bela Bartokut dhe “Junglebook-Medley”. “Me Petrit Çekun, posti i intendantit është plotësuar me personin perfekt. Çeku i lindur në Kosovë në vitin 1985 konsiderohet si njëri ndër kitaristët më interesantë të kohës sonë. Ai e bën kitarën të prezantohet në një dritë krejtësisht tjetër”, thotë Manze, transmeton albinfo.ch.

SERBIA FINANCON DOKUMENTARIN PËR DËSHTIMIN NË KOSHARE

Po mblidhen të dhëna për një dokumentar, i cili do të fokusohet në betejat e Koshares dhe Pashtrikut, në vitin 1999, të cilën ushtria serbe e humbi në përballje me UÇK-në

të cilët janë akuzuar, por e kanë mohuar të kenë qenë përgjegjës për krime lufte gjatë konfliktit në Kosovë, do të shërbejnë si konsulentë jozyrtarë për dokumentarin me tre pjesë, u lajmërua të enjten, transmeton KultPlus. Dokumentari mbi betejat në Koshare dhe Pashtrik në vitin 1999 po prodhohet nga Ministria Serbe e Mbrojtjes dhe televizioni publik RTS.

“Oficerët po merren në pyetje për filmin, por në një farë mënyre ata janë gjithashtu konsulentë ekspertë,” tha regjisori e dokumen-



tarit, gazetarja e RTS Sllagjana Zariq, në një konferencë shtypi në Beograd. Beteja në postën ushtarake të Koshares u zhvillua midis Ushtrisë Jugosllave dhe Ushtrisë

Çlirimtare të Kosovës nga 9 prilli deri më 10 qershor 1999. Luftimet në malin Pashtrik, në kufirin midis Kosovës dhe Shqipërisë, vazhduan nga 26 maji deri më 14 qer-

shor të të njëjtit vit, shkruan Balkan Insight. E pyetur nga BIRN për koston e dokumentarit, regjisori Zariq tha se realizimi do të bëhet me ndihmën e forcave të armatosura serbe, ndërkohë që intervistat nuk kushtojnë asgjë.

Shlivançanin tha se pyetja e BIRN-it në lidhje me koston “e zemëroi atë” dhe ai nuk iu përgjigj pyetjes pasardhëse në lidhje me padinë penale të ngritur kundër tij nga HLC-ja. Dokumentari prej tre pjesësh do të shfaqet për herë të parë me rastin e 20 vjetorit të betejës në Koshare më 9 prill 2019.

Gjenerali në pension i Ushtrisë Jugosllave, Dragan Zhivanović, dhe koloneli Dushko Shlivançanin,

SIPAS "TUTTOMERCATOWEB"

VISAR MUSLIU PRANË KALIMIT TE XHENOVA

Xhenova e pëlqen 23-vjeçarit dhe po punon me menaxherin e tij, Leonardo Korsi, i njëjti që menaxhon dhe Goran Pandevin. Cekim, para disa ditëve u përfol se ai kishte arritur marrëveshje me KF Shkëndija, por deri më tani ky lajm nuk u zyrtarizua as nga vet futbollisti po as nga drejtuesit e klubit tetovar, andaj gjatë ditëve në vazhdim pritet të shihet se cili do të jetë klubi i ri i 23 vjeçarit nga Gostivari

Shkup, 26 janar - Një klub i Serisë A interesohet për Visar Musliun që aktivizohet me Maqedoninë. Mbrojtësi i lindur në Gostivar, sapo është liruar nga Vardari dhe mund të kalojë në futbollin italian, bën të ditur tuttomercatoweb". Xhenova e pëlqen 23-vjeçarit dhe po punon me menaxherin e tij, Leonardo Korsi, i njëjti që menaxhon dhe Goran Pandevin. Cekim, Musliu ka kualitet dhe të ardhme. Ai zhvilloi ndeshje shumë të mira përballë Italisë në ndeshjet

eliminatore sidomos ndeshja në Torino, ku verdhekuqtë luajtën 1-1. Sipas "tuttomercatoweb" kjo solli Musliun në vëmendjen e shumë klubeve mes tyre edhe të Xhenovas. Ata që e pëlqejnë shumë mbrojtësin dhe kanë nisur punën për ta marrë atë në Liguriam. Duke marr parasysh se Musliu është një lojtar ekstrakomunitar, dikush tjetër duhet të largohet nga Xhenova që t'i lirojë atij vendin. Lojtari numëron katër ndeshje dhe një gol me përfaqësuesen e Maqedonisë,

ndërsa para disa ditëve u përfol se ai kishte arritur marrëveshje me KF Shkëndija, por deri më tani ky lajm nuk u zyrtarizua as nga vet futbollisti po as nga drejtuesit e klubit tetovar. Cekim, deri më tani ka luajtur për Renovën, St Galen U21 dhe së fundmi Vardari. Me këta të fundit ai luajti në garat e Ligës së kampionëve dhe Liga Evropës. (B.K.)



Vjen fitorja e parë për Shkëndijën

Pas humbjes 2-1 nga Cyrihu, Shkëndija dje ka zhvilluar kontrolluesen e dytë në Antalia, në kuadër të fazës së dytë të përgatitejeve. Me rezultatin e thellë 4-1 kuqezinjtë kanë mundur Olimpik Donjeck nga Ukraina. Lideri në elitën e futbollit vendor ishte superior në këtë përballje gjatë 90-të minutave. Serinë e golave e filloi Zhunior, ndërsa në listën e golashënuesve u regjistruan edhe Radevski, Ibraimi dhe Shefiti. Ndërkohë, ndeshjen e ardhshme kuqezinjtë do ta zhvillojnë më 30 janar ndaj Dinamo Zagrebit.

Renova arrin fitoren e dytë

Skuadra e Renovës ka arritur edhe fitoren e dytë pas asaj me Pobodën 1-0 në kuadër të ndeshjeve kontrolluese. Në Ohër bardhekaltërit, mundën kampionët e dimrit të Ligës së Dytë Perëndim, Vëllazërimin me rezultatin e thellë 5:0. Autor të golave për të përzgjedhurit e trajnerit Vlatko Kostov ishin: Mishkovski, Cvetanovski, Stojanovski, Sadiki dhe Skenderi. Ndishjen e radhës, Renova do ta zhvillojë më 28 janar kundër skuadrës serbe të Javor.

PËRFUNDON MAKTHI PËR KUMANOVARIN

Aliji në Serinë B italiane



Shkup, 26 janar - Përfundon makthi për Naser Alijin. Pas gjashtë muajve pa skuadër, mbrojtësi i Kombëtares së Shqipërisë transferohet në Serinë B italiane, ku do të mbrojë ngjyrat e Virtus Entellas. 24-vjeçari i lindur në Kumanovë firmosi me skuadrën e re, me detajet e kontratës që ende nuk janë bërë publike.

Kuqeziu pozoi me fanellën e ekipit të ri dhe menjëherë i është bashkuar grupit të drejtuar nga trajneri Aglietti. Aliji cilësohet një përforcim i rëndësishëm për Virtus Entellan me skuadrën që pas 22 javëve të luajtura në Serinë B ka grumbulluar 24 pikë dhe lufton për të evituar rënien

nga kategoria. Për mbrojtësin e majtë kjo është skuadra e katërt në karrierë, pasi më parë ka luajtur me Bazelin dhe Vaduzin në Zvicër, dhe së fundmi te Kaiserslautern në Bundesligën 2. Pikërisht klubi gjerman e la të lirë Alijin në verën e vitit 2017 me lojtarin që nuk gjeti skuadër në gjysmën e parë të sezonit. Megjithatë, djaloshi nga Kumanova cilësohet një element i rëndësishëm për Kombëtaren shqiptare, me trajnerin Kristian Panuqi që e grumbulloi në miqësoren e fituar 3-2 në Turqi, duke e aktivizuar në minutat e fundit të lojës si zëvendësues të goleadorit Armando Sadiku.

Shkupi synon mbrojtjen e dy titujve

Shkup, 26 janar - Kampioni aktual i Maqedonisë në futsal Shkupi, është vënë në kërkim të një paraqitje sa më të mirë në sezonin e dytë të këtij kampionati ku do të duhet të mbrojë titullin e kampionit. Trajneri Lekiq nga e gjithë ajo që është treguar deri më tani është i kënaqur, por kërkon më shumë. "Çdo herë mundet më mirë. Për dallim nga sezoni i shkuar, sivjet kemi pësuar një disfatë të paparashikuar edhe atë nga Kratova. Kjo sa do pak na i ka prishur planet. Sa iu përket ndeshjeve të tjera mund të jemi të kënaqur nga ekipi", tha për "Alsat-m" Zoran Lekiq, trajner i KMF Shkupi. Drejtuesit e Shkupi por edhe trajneri, shpresojnë se

krahas dy humbjeve në sezonin e parë, këta ende në garë janë për të mbrojtur titullin e kampionit dhe të për të fituar kupën. "Sportive është që të shpresojmë, por me këto dy humbje që i kishim njërin nga kundërshtarit direkt Velesi na u vështirësuan punët. Megjithatë kampionati është i gjatë dhe ka ende shumë ndeshje për tu luajtur. Në sport nëse nuk angazhohesh maksimalisht mund të humbasësh nga secili kundërshtar, kjo vlen veçanërisht për mini-futbollin", deklaroi Lekiq. Cekim, në radhët e Shkupit është rikthyer Erkan Seferi dhe Rexhep Sulejmani, përforcime me të cilat edhe ka marrë fund merkatoja dimërore.



FEDERER-ÇILIÇ DHE HALEP-VOZNIACKI FINALET E "AUSTRALIAN OPEN"

Federer do të përballet në finale me kroatit Marin Çiliç, që një ditë më parë eliminoi britanikun Edmund. Ndërkohë, tenistja daneze Karoline Vozniacki dhe ajo rumune Simona Halep janë dy finalistet e grand slemit të "Australian Open" për femra, finale që do të luhet të shtunën në mëngjes në Melburn



Rogjer Federer siguron finalen e "Australian Open" me vetëm një set të fituar ndaj koreanit Čung. Në fakt, kjo përballje gjysmëfinale nuk përfundoi, pasi kundërshtari i zviceranit u tërhoq në setin e dytë për shkak të një dëmtimi. 37-vjeçari dominoi në setin e parë ndaj numrit 58 në botë, duke e mposhtur lehtësisht 6-1, ndërsa në setin e dytë udhëhiqte 5-2 kur Čung njoftoi tërheqjen përfundimtare për shkak të problemeve fizike. Federer do të përballet në finale me kroatit Marin Čiliç, që një ditë më parë eliminoi britanikun Ed-

mund. Ndërkohë, tenistja daneze Karoline Vozniacki dhe ajo rumune Simona Halep janë dy finalistet e grand slemit të "Australian Open" për femra, finale që do të luhet të shtunën në mëngjes në Melburn. Ato kanë triumfuar në sfidat gjysmëfinaliste, duke u përballur për herë të parë ndaj njëra-tjetrës në finale e një grand slemi. Një finale e madhe, pasi përballë njëra-tjetrës do të jenë numrat 1 dhe 2 në botë. Ndryshe, tenistja daneze Karolin Vozniacki ishte e para që shkoi në finale, pasi fitoi 2-0 (6-3, 7-6) ndaj belges Elise Mertens, ndeshje me rivali-

tet vetëm në setin e dytë, që u vendos në "tie break" në favor të numrit 2 në botë. Ndërsa seti i parë u dominua dhe fitua pa probleme nga Vozniacki, që pati epërsi gjatë gjithë kohës. Një kualifikim i merituar i Vozniacki në finalen e "Australian Open", ish-numri 1 në botë 8 vite më parë, që për herë të tretë në karrierën e saj kualifikohet për në finale e një grand slemi, ku do të kërkojë triumfin e parë. Në gjysmëfinalen e dytë, Simona Halep mundi 2-1 (6-3, 4-6, 9-7) gjermanen Angelique Kerber, një fitore e vështirë e numrit 1 në botë, që

mundi një teniste që e ka fituar dy vite më parë këtë turne. Një ndeshje e hapur dhe me rivalitet në të trea setet, me Halep që fitoi të parin e më pas kundërpërgjigjet Krber në të dytin.

Tenistja gjermane pati shansin ta mbyllë ndeshjen në setin e tretë, por humbi 2-1 topa për ta fituar lojën dhe kjo motivoi Halep, që rikuperoi dhe më pas fitoi 9-7 pas një seti maratonë, duke kërkuar triumfin e parë në një grand slem.

Uilliams rikthehet për "Federations Cup"

Tenistja amerikane Serena Uilliams është gati për t'u rikthyer në fushë një vit pas triumfit të fundit në grand slem-in e Australian Open. Federata Amerikane e Tenisit ka bërë me dije se ish-numri 1 në botë do të luajë për kombëtaren në ndeshjet e turit të parë të "Federations Cup" ndaj Holandës, takime që do të zhvillohen në datat 10-11 shkurt, në Karolinën e Veriut. Një rikthim pa shumë presion ky për "panterën e zezë", që në janar tentoi të luante në Melburn, por nuk ishte ende gati për shkak se nuk ishte në formë pas shtatëzansisë. Më 30 dhjetor, Serena Uilliams luajti në një ndeshje "show" në Abu Dabi, ku u mund në 3 sete nga Jelena Ostapenko, ku dhe testoi veten para se të tërhiqej nga "Australian Open". Ajo ishte ende mbipeshë, mezi lëvizte në fushë dhe bënte shumë gabime në shërbim, por nuk i mungonte grinte për të treguar se është ende më e mira. Në krah të Serenës në këtë turne do të jetë edhe motra e saj më e madhe Venus Uilliams, që do të



Publicitet

Uilliams rikthehet për "Federations Cup"



Tenistja amerikane Serena Uilliams është gati për t'u rikthyer në fushë një vit pas triumfit të fundit në grand slem-in e Australian Open. Federata Amerikane e Tenisit ka bërë me dije se ish-numri 1 në botë do të luajë për kombëtaren në ndeshjet e turit të parë të "Federations Cup" ndaj Holandës, takime që do të zhvillohen në datat 10-11 shkurt, në Karolinën e Veriut. Një rikthim pa shumë presion ky për "panterën e zezë", që në janar tentoi të luante në Melburn, por nuk ishte ende gati për shkak se nuk ishte në formë pas shtatëzansisë. Më 30 dhjetor, Sere-

na Uilliams luajti në një ndeshje "show" në Abu Dabi, ku u mund në 3 sete nga Jelena Ostapenko, ku dhe testoi veten para se të tërhiqej nga "Australian Open". Ajo ishte ende mbipeshë, mezi lëvizte në fushë dhe bënte shumë gabime në shërbim, por nuk i mungonte grinte për të treguar se është ende më e mira. Në krah të Serenës në këtë turne do të jetë edhe motra e saj më e madhe Venus Uilliams, që do të luajnë së bashku në lojën dyshe në një ndeshje zyrtare pas gati 3 vitesh si dhe tenistja tjetër Koko Vandeweghe.

Republika e Maqedonisë
Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor

SHPALL

DRAFT ndryshim të A- lejes së integruar ekologjike për SHNTSH KOOP INZHENERING Kumanovë Bazë e asfaltit

Instalacioni dorëzoi kërkesë deri tek MMJPH për ndryshimin e A-lejes së integruar ekologjike. Instalacioni sipas rregullores për caktimin e aktiviteteve të instalacioneve.

I përket aktiviteteve nga shtojca 1 pika:

3. Industria e mineraleve

3.5 Bazë stacionare asfalti

Koordinatat e lokacionit sipas sistemit nacional koordinativ:

(H=4666097,57; U=7557086,04);

(H=4665942,39; U=7557078,27);

(H=4665907,96; U=7557239,25);

(H=4665981,11; U=7557254,44);

(H=4666106,65; U=7557234,34);

Personi për kontakt:

Agim Ljati

Tel. 031417702

Lloji i aktivitetit, bazë e asfaltit

Drejtoria për mjedis pranë MMJPH përgatiti draft leje të integruar ekologjike:

DRAFT ndryshim të A-lejes së integruar ekologjike

Për:

SHNTSH KOOP INZHENERING Kumanovë

Baza e asfaltit

Draft ndryshimi i lejes do të jetë i publikuar në ueb faqen zyrtare të Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor www.moecp.gov.mk

Informata në lidhje me lejen, publiku i interesuar mund të marrë në Ministrinë e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor në numrin e telefonit 076 456717 ose në e-mailin: f.baluu@moecp.gov.mk

Publiku i interesuar në afat prej 14 ditëve nga dita e publikimit në mjetet për informim, mund të dërgojë vërejtjet e veta në formë të shkruar deri tek Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor në adresën në vijim: Bulevardi "Goce Dellçev" nr. 18 (ndërtesa e MTV-së) 1000 Shkup.

REAL MADRID NUK HEQ DORË

300 MILIONË EURO PËR TË NËNSHKRUAR ME NEJMARIN

Siç është raportuar të premten nga gazeta "Marca" në faqen e parë, Real Madridi do të hyjë fuqishëm në merkato, me arkat financiare të klubit në kushte të mira. "Një revolucion 300 milionësh" është titulli në kopertinën e "Marca", e cila shton se "Real Madridi nuk ka probleme likuiditeti për rinovimin

Real Madrid ka 300 milionë euro gati për të nënshkruar me Nejmarin, yllin brazilian të Paris Sen-Zhermenit. Florentino Perez, presidenti i "Los Blancos", ka nisur tashmë një revolucion në ekipin që financon, në mënyrë që të rinovojë grupin e lojtarëve në merkaton e verës së ardhshme. Dështimi i Real Madridit në këtë sezon e detyron atë të bëjë një rinovim të plotë dhe Nejmar është qëllimi numër një. Siç është raportuar të premten nga gazeta "Marca" në faqen e parë, Real Madridi do të hyjë fuqishëm në merkato, me arkat financiare të klubit në kushte të mira. "Një revolucion 300 milionësh" është titulli në kopertinën e "Marca", e cila shton se "Real Madridi nuk ka probleme likuiditeti për



rinovimin. Arkat e klubit janë më shumë se të mbushura". Nënshkrimi i Nejmar është një prioritet për Florentino Perez, ndërkohë që Cristiano Ronaldo duket të jetë i përjashtuar tërësisht nga projekti i ri. Kjo është arsyeja pse 300 milionët që Real Madridit ka në dorë për të nënshkruar me

Nejmarin, duhet të shtohen edhe me përfitimet që mund të rrjedhin nga shitjet e lojtarëve aktualë madrilenë. Megjithatë, duhet të kujtojmë se PSZH-ja është e qetë dhe e di se një shkëmbim mes Cristiano Ronaldos dhe Nejmar është e pamundur tani për tani.



Murinjo në "Old Trafford" deri në vitin 2020

Jose Mourinho ka rinovuar kontratën e Manchester Junajtedi me një marrëveshje që do ta mbajë në "Old Trafford" në 2020. Ishte përfolur shumë në kohët e fundit për një rinovim të trajnerit portugez dhe më në fund lajmi është konfirmuar zyrtarisht edhe nga klubi më i pasur në botë. "Jam shumë i lumtur dhe krenar që jam trajneri i Manchester Junajtedit. Dua të falënderoj pronarët dhe Z. Voodvard për vlerësimin që kanë për punën dhe dedikimin tim. "Kemi standarde shumë të larta – të fitojmë tre trofe në një sezon – por këto janë standardet që pres t'i përbushë skuadra ime. Po krijojmë kushtet e duhura për një periudhë të suksesshme për të paktën tre vitet e ardhshme. Falënderimet e mia, patjetër, shkojnë edhe për stafin dhe lojtarët e mi; pa empatinë dhe shoqërinë e tyre kjo gjë nuk do të ishte e mundur. I dua lojtarët e mi dhe do të jetë një kënaqësi të vazhdoj punën time së bashku me ta në tre vitet e ardhshme. Nuk mund ta mbyll pa falënderuar tifozët. E përsëris, të jesh trajneri i Manchester United është një nder çdo ditë dhe jam shumë i lumtur", deklaroi Murinjo pas rinovimit të kontratës.

Superofertë për Nainggolanin

Klubi kinez i Guangzhou, sipas "International Times", po përgatiti një super ofertë për mesfushorin e Romas, Ragjja Nainggolan, verën e ardhshme. Gjithmonë sipas këtyre zërave, skuadra kineze do t'i ofrojë lojtarit 12 milionë euro në sezon. Fabio Cannavaro, ish-mbrojtësi i Italisë dhe trajneri i Guangzhou, është munduar ta marrë lojtarin që në merkaton e janarit, por Monçi, drejtori i përgjithshëm i klubit verdhekuq, ka refuzuar ofertat e bëra nga kinezët. Gjithsesi, ky qëndrim mund të ndryshojë verën e ardhshme. 29-vjeçari ka luajtur 23 ndeshje në këtë sezon dhe ka realizuar dy gola, që janë shoqëruar edhe me katër asistime. Vlera e tij në merkaton është 45 milionë euro.



Junajted gati të paguajë klauzolën për algjerianin

Manchester Junajtedi është gati të paguajë klauzolën e lirim të mbrojtësit të majtë të Napolit e cila është 60 milionë euro, sipas raporteve në Itali. Lojtari i përfaqësueses algjeriane nënkroi një kontratë të re me Napolin vetëm muajin e fundit, por ka një klauzolë lirim në kontratën e tij e cila është e vlefshme vetëm për klubet jashtë Italisë. Sipas "Rai Sport", "Djajtë e Kuq" e kanë bërë të qartë se janë gati të paguajnë shumën, e cila do t'i lejonte të negocionin me Ghou-


lam. Kjo është arsyeja pse Napoli ka filluar kontaktet me Alejandro Grimaldo i cili aktualisht luan te Benfica. Gjithsesi, të dyja operacionet mund të ndodhin në fund të sezonit, pasi Junajted sapo ka shpenzuar një shumë të madhe parash për të sjellë në "Old Trafford" Aleksis Sanchez. Edhe Napoli nuk do të ishte gati të hiqte dorë nga lojtari në mes të sezonit, por do ta lejonte të largohej në verë pasi do të kishte më shumë kohë për të gjetur një zëvendësues të denjë.



SAUTEMPTONI THYEN REKORDIN E TRANSFERIMEVE

Pagoi 25 mln euro për Karrillon, pritët Promes

Sautemptoni ka thyer rekordin e transferimeve në merkato, duke realizuar blerjen më të shtrenjtë në historinë e klubit pasi pagoi 25 milionë euro për blerjen e Guido Karrillo nga Monako. Karrillo, që do të mbajë fanellën me numrin 9 në "St. Mary", pasi firmosi për tre vite e gjysmë, do të bashkohet sërisht me trajnerin Maurisio Pellegrino, me të cilin ka punuar te Estudiantes. Por, sipas shtypit anglez ky rekord nuk do të zgjasë shumë sepse në ditët e fundit të kësaj merkatoje, Sau-



temptoni do të paguajë 35 milionë euro te Spartak Moskë për

të marrë Quinci Promes. Blerja e argjentinasit Karrillo ka thyer

rekordin e mëparshëm të "shenjtorëve" që mbahej nga Mario Lemina, i cili kaloi nga Juventusit te Sautemptoni për 22 milionë euro gjatë merkatos së verës.

Ai do të debutojë të shtunën në ndeshjen e Kupës së Anglisë kundër Uatford. Karrillo ka shënuar pesë gola në 23 ndeshje për Monakon gjatë këtij sezoni, por rrallë herë ka qenë titullar. Me Monakon, në dy vjet e gjysmë, ai ka shënuar 15 gola në 65 ndeshje, 43 prej të cilave i nisur si zëvendësues.

PASI NUK IU PËRMBAJTËN URDHRAVE QË MOST TË DALIN JASHTË SHTETIT

Pavarësisht këtij urdhri, ku thuhej edhe se të dy duhet të qëndronin 500 metra larg njëri-tjetrit, çifti ka vendosur të injorojë vendimin dhe të martohet në Las Vegas katër muaj më vonë. Pas martesës, sipas shtypit spanjoll, ata kanë shkuar në Bahama për muajin e mjaltit. Por në momentin e kthimit, mbrojtësi i Atletiko Madridit dhe gruaja e tij, janë ndalur në aeroportin "Adolfo Suarez-Barajas" të Madridit

Mbrojtësi i Atletiko Madridit, Lukas Hernandez, rrezikon deri në një vit burg për shkak se është martuar në Las Vegas, ndërkohë që ishte urdhëruar që të mos dilte jashtë shtetit. Shkurtin e vitit të kaluar, Hernandez dhe gruaja e tij, Amelia Ossa Llorente, janë urdhëruar që të bënin 31 ditë shërbim social dhe që të mos dilnin jashtë shtetit për gjashtë muaj. Një vendim ky që është marrë pasi lojtari është shpallur fajtor për dhunë në familje. Pavarësisht këtij urdhri, ku thuhej edhe se të dy duhet të

LOJTARI I ATLETIKOS RREZIKON 1 VIT BURG



qëndronin 500 metra larg njëri-tjetrit, çifti ka vendosur të injorojë vendimin dhe të martohet në Las Vegas katër muaj më vonë. Pas

martesës, sipas shtypit spanjoll, ata kanë shkuar në Bahama për muajin e mjaltit. Por në momentin e kthimit, mbrojtësi i Atletiko Ma-

dridit dhe gruaja e tij, janë ndalur në aeroportin "Adolfo Suarez-Barajas" të Madridit. Madje, Hernandez ka kaluar natën në burg. Tani,



prokuroria ka kërkuar një vit burg për lojtarin, ndërsa bashkëshortja e tij është lënë e lirë pasi është zbuluar se ajo nuk ishte informuar zyrtarisht në lidhje me vendimin e gjykatës për të mos u larguar nga vendi. Duket si një film, por Hernandez rrezikon seriozisht të përfundojë në burg.

Publicitet

HENDBOLLI MË I MIRË NË SMARTFONIN TUAJ TË RI

Bëjmë tifo së bashku për hendbollistët tanë më të mirë, në rrjetin më të mirë në Maqedoni.

Me bonusin hendbollistik prej 3.000 denarë me Smart M zgjidhni Samsung Galaxy J3 (2017) tuaj të ri për 199 denarë në muaj. Plus, kënaquni duke surfuar me 15 GB Internet.

Nxtoni, sasitë janë të kufizuara, ndërsa bonusin mund ta shfrytëzoni deri më 31 janar.

VETËM DERI
MË 31 JANAR

**SAMSUNG
GALAXY J3** (2017)
199 DENARË
NË MUAJ



NDAJI PËRJETIMET





DASHI 21. mars - 20. prill

Një fazë e re do të fillojë për ju, veçanërisht në një nivel sentimental dhe emocional. Nga sot, siguria do të rritet dhe kjo do të bëjë që marrëdhënija tuaja të jenë më të mira. Beqarët po dalin nga një gjendje jo e mirë që kanë përjetuar dhe do të shohin drejt horizonteve të reja. Do të jeni gati për ndryshime që mund të nxisin kontakte dhe promovime të reja në punë.



DEMI 21. prill - 21. maj

Sot yjet do të jenë edhe më të mirë se ditët e fundit, ju keni Mërkurin dhe Saturnin në krah, por në dashuri do të jetë koha për të bërë edhe disa kontrollë të rëndësishme. Për beqarët është koha të fokusohen te njohje të reja. Në aspektin profesional do të thirreni për të bërë zgjedhje të rëndësishme, mund të ndryshoni rolin, grupin ose detyrën, madje edhe aktivitetin.



BINJAKET 22. maj - 21. qershor

Një ditë e rëndësishme për ndjenjat, ju gjithashtu mund të merrni propozime interesante. Për të arritur qëllimin e një marrëdhënieje të qëndrueshme dashurie, është më mirë të fokusohesh te dialogu i mirë. Beqarët do të duhet të pranojnë ftesat për takime nëse duan të ndryshojnë statusin dhe përjetojnë emocione.



GAFORRJA 22. qershor - 22. korrik

Ditë e bukura, ju keni zemrën plot shpresa dhe projekte që mund t'i arrihi në një kohë të shkurtër. Çiftet e konsoliduara tashmë do të kenë shumë shigjeta në harkun e tyre për ta mbajtur gjallë zjarrin! Flirt dhe aventura edhe për beqarët, ju do të jeni plot hijeshi dhe intrigues, si gjithmonë! Lajme të mira në horizont dhe perspektivat e reja të punës do të karakterizojnë këtë ditë.



LUANI 23. korrik - 22. gusht

Një bllokim në marrëdhënien tuaj në çift ju bën disi të shqetësuar dhe të papërqendruar. Atmosfera do të jetë e rënduar dhe kuadratura e Jupiterit ju fton të jeni të duruar. E premtja, nuk do të jetë e mirë as kur flasim për beqarët, dashuria ju dënon dhe nuk ju jep paqe! Yjet ju shfaqin sot sfidë në punë dhe do ndjeheni mjaft të lodhur. Merrni një pushim.



VIRJERESHA 23. gusht - 23. shtator

Ka ardhur koha për sqarim në familje ose në jetën tuaj në çift. Mos hezitoni ta bëni këtë, në sajë të mbështetjes së Hënës në Dem nuk do të keni ndonjë problem. Zemrat e vetmuara do të duhet të vendosin nëse do të ndërmarin një hap të rëndësishëm, mjaft me hezitimet e padobishme! Besoni në aftësitë tuaja, ndiqni impulset dhe vendosni pa vonesë në aspektin profesional.



PESHORJA 24. shtator - 23. tetor

Shumë nga problemet në çift do të zgjidhen sot me një kuptim dhe disponueshmëri të vogël. Mjaft me konflikte të brendshme, ju rrezikoni nënshtrimin e partnerit/es! Beqarët do të duan të përjetojnë përvoja të reja dhe kjo ditë do jetë me fat për ta. Nëse keni filluar një punë të re, ndoshta ju jeni të shqetësuar për financat tuaja. Një mik do t'ju ndihmojë.



AKREPI 24. tetor - 22. nëntor

Një diskutim i animuar me partnerin/en mund të jetë tërësisht i parëndësishëm në marrëveshje është e thellë. Filloni të shqetësoheni nëse bilanci i qetësisë është thyer! Beqarët do të duhet të qëndrojnë larg nga premtimet e rreme dhe të përpiqen t'i besojnë atyre që janë të sinqertë. Sukseset e mëdha në profesion do të ngrenë gjendjen shpirtërore.



SHIGJETARI 23. nëntor - 21. dhjetor

Marsi është në një pozicion të favorshëm dhe ndihmon çiftet në krizë të rivlerësojnë marrëdhëniet e tyre. Shumë lidhje do të ruhen në sajë të ngarkesës tuaj erotike! Venusi mbron beqarët dhe siguron shanse të shkëlqyera për të takuar njerëz me të cilët do të jetojnë emocione të jashtëzakonshme.



BRICJAPI 22. dhjetor - 20. janar

Sot ju do të keni nga partneri/ja stabilitetin emocional që kërkonte dhe që keni nevojë për të! Për fat të mirë do të jeni më të ndjeshëm se kurrë. Zemrat e vetmuara do të jenë në gjendje të bëjnë takime që do të jenë shumë të këndshme, por që do t'i vënë ato në agjitacion të fortë.



UJORI 21. janar - 19. shkurt

Dita jote shoqërohet me reflektime, vlerësime që premtjnë të rivendosin atë që nuk funksionon. Marrëdhëniet me partnerin/en mund të jenë pak të tensionuara, por është vetëm një moment! Takime me fat për beqarët, flirtet dhe aventurat do të jenë intensive! Jeta juaj profesionale është më e qëndrueshme se më parë, por keni shumë projekte në mendje për të përfunduar.




PESHQIT 20. shkurt - 20. mars

Do të ketë shumë emocione dhe surpriza në dashuri. Nëse jeni në çift, do të planifikoni të ardhmen tuaj së bashku me të dashurin/en, nëse jeni vetëm do të përjetoni emocione të reja dhe njohje që do ju pushtojnë zemrën dhe mendjen. Një intuitë juaja e pabesueshme do t'ju vërë në rrugën e duhur për të zgjidhur një problem të komplikuar, ndoshta me një natyrë financiare.

LLOJ DHEU QË PËRDORET PËR TË BËRË ENË	SUPER-MODELJA DHE AKTORJA AUSTRALIANE NGA FOTO	DYQAN KU SHITEN LIBRAT	KËNGËTARJA TURKE, KOSHAN LUFTETAR ME DEMA		POLICI I NJOHUR TE "TË PAPREKURIT", ELIOT (shq.)	VEND HISTORIK NË SHBA								
FUTBOLLISTI ARGJENTINAS, MESSI														
PËRSHTYPJA														
JO E VJETËR				IMTËSOJ NJË PEMË TROPIKALE										
KËNGËTARJA ITALIANE, RAFAELA					OKSIGJEN I ILIRISË, ILIR									
PUSHTETI I LARTË I NJË MBRETI (fig.)						LYERJE ME EMAL (shum.)								
ZANORJA E DYTË DHE E KATËRT			AKTORI, DELON QË I PËRKET MAJËS, MAJOR								SHTIMI I POPULLSISË VËND I PUSHTUAR NGA KINA	KËNGËTARI AMERIKAN, OZBORN	BIMË BARISHTORE E KËNETAVE DHE E LIQENEVE	KËNGËTARJA TURKE, SAJËN
RREZE		VIZATUESË E FILMAVE VIZATIMOR MENJANIMI NGA GARAT E MËTEJME												
LEVIZJE E NJË GRUPI POPULLSIE PËR TË SHKËPUTUR NGA NJË SHTET														
QË KA SHUMË RROKJE AKTORI, NOLT				KILOGRAM KËNGËTARJA ITALIANE, PAUER				O. L. I PAGJAK						
	PERËNDI E VDEKJES (mit.hinduse) NJË PUJE E NGROHTË				I MITUR RRUJICË				AI QË DREJTON NJË MJET FLUTURUES					
KULLAT PËR RUAJTJEN E DRITHËRAVE							STADIUMI FUTBOLL NË BUDAPEST SHËRBËTOR ME UNIFORMË							
VENDI KU LIDHEN ESHTRAT, KYÇ			HOTELE NË AUTOSTRADË FUTBOLLISTI I VJETËR GJERM., UVE						INTENSITET SHKOVA					
QË I PËRKET LIRIKËS						ANAS I SRI LANKËS NJËSI JAPONEZE PËR VËLLIM								
PRODUKT I RREZATIMIT							ALBUM I ROK GRUPIT LOS LOBOS TON							
GALERITË PUBLIKE TË PIKTURAVE														

FJALËKRYQ KLASIK



HORIZONTALISHT: 1. Burrë i vjetër në moshë; 5. Enti kombëtar aeronautik në SHBA; 8. Pengesa e pa kapërcyeshme; 10. Lloj guri me prejardhje vullkanike; 12. Jam në pajtim, pajtohemi (turq.); 13. Kopsht ose arë pranë shtëpisë; 15. Njësi japoneze për vëllim; 16. Liman në Izrael; 17. Përziej, trazoj; 19. Frikë patologjike nga vaksinimi; 21. Mosbesim në zotin, femohim; 22. Senatori amerikan, Bob; 23. Milje japoneze; 24. Emër mashkulli; 26. Autotarga e Tetovës; 27. Aktorja amerikane, Sams; 29. Të minuarit (shum.); 31. Një e panjohur në matematikë (shq.); 32. Shkrimtari ynë, Mekuli.

VERTIKALISHT: 1. Të vendosurit e pllakateve (shq.); 2. Që ka loze, që është me loze; 3. Lloj druri për ndërtim të anijeve; 4. Posedon; 5. E sëmure nga narkotikët; 6. Sergio Tacchini; 7. Automjet që mbart ujë, naftë etj.(shum.); 8. Bareshë e bravareve; 9. Dyanshmëri; 11. Mbeturinat e kafshëve parahistorike; 14. Lumë në Uels; 17. Rekruti (turq.); 18. Kimisti anglez, Aleksandar (nobelist); 20. Servizio Informazioni Militari; 25. Macë e egër; 28. Bardhë (turq.); 30. Miliampër.

ZGJIDHET: M. DELTINA, LIONEL, MBRESA, ERE, IM, KARVA, O. FRONI, EI, ALEN, R. ANIMATORE, SEPARATIZËM, POLISILABRIKE, NIK, KILE, OL, MAR, MITAR, NAKATOS, VAKSINOFORI, ATEIZËM, DOL, RI, MASAR, TE, EMA, MINIMET, IKSI, ESAT.



ÇOKOLLATA, ILAÇI PËR TË LUFTUAR KOLESTEROLIN DHE DIABETIN

Sipas një studimi konsumi i çokollatës thuhet se çdo ditë bën mirë për shëndetin tonë. Kakaoja nga e cila përbëhet çokollata, përmban një sasi të konsiderueshme magnezit dhe për pasojë stimulon prodhimin e serotoninës, hormonit

të lumturisë. Mjafton një copë çokollatë në ditë për të larguar trishtimin. Çokollata e zezë cilësohet gjithashtu si ilaç për të luftuar kolesterolin dhe diabetin. Gjithçka pasi përmban një lloj acidi i cili rregullon qarkullimin e gjakut dhe fla-

vonoidet, të cilat favorizojnë reagimin e qelizave ndaj insulinës. Ngrënia e një cope çokollatë çdo ditë i bën mirë zemrës, pasi flavonoidet reduktojnë rrezikun e sëmundjeve kardiovaskulare. Natyrisht duhet të jetë çokollatë e zezë.



Qeni vret me armë zjarri gjuetarin

Një gjuetar është qëlluar për vdekje nga qeni i tij, në një aksident të çuditshëm që ndodhi kur kafsha kërcëu dhe kthetrat e tij goditën pjesën e këmbëzës së pushkës. Sergej Terekhov, 53 vjeç, i kishte lënë dy qentë në makinën "Lada" përpara një ekspedite gjuetie në rajonin e largët jugor të Saratovit të Rusisë. Por një nga kafshët papritmas kërcëu dhe aksidentalisht tërhoqi këmbëzën e pushkës së tij, TOZ-34. Plumbi goditi zotin Terekhov në bark dhe ai u rrëzua në tokën e ngrirë. Miqte nxituan për ta çuar në spital, por mjekët nuk ishin në gjendje ta shpëtonin dhe ai vdiq më pak se një orë pasi u qëllua nga qeni. Aksidenti ndodhi në një vend popullor gjuetie tre milje nga fshati Dyakovka.

Gjendet një pjesë e paprekur e murit të Berlinit



Historiani amator Cristian Borman ka gjetur një pjesë të madhe të murit origjinal të Berlinit në pjesën e pyllit të qytetit. Borman ka thënë për DPA se ka

gjetur murin e gjatë 80 metra në paralagjen Pankov para disa vitesh dhe këtë ia kishte bërë me dije autoriteteve të qytetit nga frika se vandalët mund ta

shkatërrojnë. Muri i Berlinit ndante qytetin në dy pjesë: lindore dhe perëndimore, dhe ishte ndërtuar në vitin 1961 për t'u shembur në vitin 1990.

Ish-kancelari Schroeder 73 vjeç drejt altarit!

Ish-kancelari gjerman, Gerhard Schroeder, do të martohet vjeshtën e ardhshme, me partneren e tij koreano-jugore Kim So Yeon, sipas agjencisë koreano-jugore të lajmeve, Yonhap, transmeton ATSH raportimin e DPA-së. Deri tani nuk janë bërë të ditura detaje të mëtejshme rreth ceremonisë së martesës së tij. Kim, 48 vjeçe, ka konfirmuar për Yonhap planet e martesës, por nuk ka dhënë detaje të mëtejshme rreth ceremonisë. Ish-lideri i socialdemokratëve, 73 vjeç njoftoi më herët se ai dhe partnerja e tij kanë planifikuar të jetojnë mes Gjermanisë dhe Koresë së Jugut. Ai e përshkroi martesën e tij të ardhshme dhe planin për të jetuar një pjesë të jetës në Korenë e Jugut si një "sfidë e re". Gjithashtu, Schroeder deklaroi se kishte planifikuar të mësonte ta fliste më mirë gjuhën koreane dhe të bënte një "jetë normale" në vend. Kjo është martesë e tij e pestë me Kim. Ai ka dy fëmijë me ish-bashkëshorten, Doris Schroeder-Koepf.



98 - Trajani emërohet Perandor romak pas vdekjes së Nervës.

661 - Kalifati Rashidun përfundon me vdekjen e Aliut.

1593 - Vatikani hap proces gjyqësor shtatëvjeçar kundër shkencëtarit Xhordano Bruno.

1671 - Pirati Henry Morgen zbarkon në Panama Siti.

1695 - Mustafa II emërohet Sulltan i Perandorisë Osmane pas vdekjes së Ahmedit II.

1710 - Cari Pjetri i Madh për herë të parë projektton buxhetin e Rusisë.

1880 - Tomas Edisoni patenton poqën elektrike.

1915 - Marinsët amerikan okupojnë Haitin.

1969 - 14 spiunë dënohen në varje në Bagdad.

1973 - SHBA dhe Vietnamit nënshkruajnë armëpushim, duke përfunduar luftën më të gjatë amerikane.

1992 - Mike Tyson gjykohe për përdhunim.

1996 - Gjermania feston për herë të parë Ditën përkujtimore të Holokaustit.

Në Amerikë janë afërsisht 223 milionë njerëz të bardhë dhe 39 milionë afrikano-amerikan, mirëpo burgjet amerikane kanë 200.000 të burgosur më shumë afrikano-amerikan sesa të bardhë.



Aq efektive janë reklamamat e McDonald-it sa që fëmijët në Amerikë posa të shohin një letër me shkronjën "M" mendojnë për McDonald-in.



Pasuria e meksikanit Carlos Slim është aq e madhe sa e 73 për qind e krejt Meksikës ose ka aq pasuri sa 75 milionë meksikan.



POLICI DJEG FAQET

Një polic iku një ditë në punë me të dyja faqet e djegur. Shoku e pyet:
- Ku e ke djegur këtë faqe? - dhe ai i tha:
- Isha duke hekuros kur ra zilja e telefonit, dhe unë vura në vesh hekurin e hekurosjes pa dashje.
- Po faqen tjetër? - e pyeti përsëri shoku.
- Pasi dogja faqen e pare mora në telefon ambulancën...



Dikush po rri në hije sot, për shkak se dikush mbolli një pemë shumë kohë më parë. (Warren Buffet)



KALENDARI HISTORIK 27 JANAR



A E DINI SE...



BARSOLETA



THËNIA E DITËS